

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Republika e Maqedonisë

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Strategjia Kombëtare për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (2017-2022)

dhe

Plani i Veprimit (2018-2020)

Ministria e Ekonomisë

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

---

*Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse, Strategjia Kombëtare për NVM (2017-2022) dhe Plani i Veprimet(2018- 2020), Republika e Maqedonisë, Ministria e Ekonomisë, Shkup, Maqedoni*

Përgatitur me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Punës në Maqedoni.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

## Përmbajtja

Lista me shkurtesa .....	6
<b>Strategjia e NVM në pika të shkurta .....</b>	<b>7</b>
Harmonizimi i Aktit për ndërmarrjet e vogla të Bashkimit Evropian .....	8
<b>PJESA 1: STRATEGJIA .....</b>	<b>10</b>
<b>1 Hyrje .....</b>	<b>10</b>
1.1 Kontekst i politikës ndërkombëtare.....	10
1.2 Kontekst i politikës kombëtare .....	12
1.2.1 Kornizë e politikës ekonomike dhe industriale .....	12
1.2.2 Kornizë e politike e NVM .....	15
<b>2 Profili i NVM-së dhe sfidat .....</b>	<b>18</b>
2.1 Definicion për NVM.....	18
2.2 Profili i NVM.....	19
2.2.1 NVM joformal.....	20
2.2 Sfidat kryesore .....	21
2.2.1 Mjedis afarist .....	21
2.2.2 Shërbime për zhvillim afarist .....	22
2.2.3 Qasje financiare .....	22
2.2.4 Kultura e sipërmarrësisë.....	23
2.2.5 Produktivitet dhe kushtet e punës .....	23
2.2.6 Përfaqësim, dialog dhe ndërmjetësim .....	23
<b>3 Vizioni, objektivat e përgjithshëm dhe objektivat e strategjisë .....</b>	<b>24</b>
3.1 Vizion i strategjisë .....	24
3.2 Objektivat e përgjithshme të strategjisë .....	24
3.3 Objektivat strategjike.....	24
3.4 Grupet e synuara .....	24
<b>4 Parime.....</b>	<b>26</b>
<b>5 Shtyllat e strategjisë.....</b>	<b>28</b>
Shtylla 1: Mjedis i favorshëm afarist .....	28
Shtylla 2: Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM-së.....	31
Shtylla 3: Ekosistem dinamik i sipërmarrjes dhe inovacionit .....	34
<b>6 Programe .....</b>	<b>36</b>

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Shtylla 1: Mjedis i favorshëm afarist .....	36
Programi 1.1: Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit .....	36
Programi 1.2: Thjeshtësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator .....	37
Programi 1.3: Fuqizimi dhe institucionalizimi i dialogut social .....	38
Programi 1.4: Përmirësim i koordinimit në grumbullimin e të dhënave për NVM për shkak të përmirësimit të politikave për mbështetjen e NVM .....	39
Programi 1.5: Përmirësimi i përfaqësuesve të NVM - Shoqata kombëtare e NVM .....	40
Shtylla 2: Sektori produktiv dhe konkurrues në NVM .....	41
Programi 2.1: Përmirësimi i shërbimeve në zhvillimin afarist .....	41
Programi 2.2: Përmirësimi i qasjes në financa .....	43
Programi 2.3: Lehtësimi i ndërkombëtarizimit .....	45
Programi 2.4: Mbështetje e zhvillimit të zinxhirit të vlerave .....	45
Shtylla 3: Sistemi dinamik i sipërmarrjes dhe inovacionit .....	47
Programi 3.1: Zgjerimi i sipërmarrësve në arsim dhe trajnim .....	47
Programi 3.2: Përmirësimi i shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në zhvillimin e NVM-së .....	48
Programi 3.3: Formimi i parqeve shkencore, teknologjike dhe inkubatorëve për inovacion .....	49
<b>7 Palët e përfshiera kyçe dhe mekanizmat për zbatim .....</b>	<b>50</b>
7.1 Koordinim nga ana e Qeverisë .....	50
7.2 Përgjegjësitë për krijimin e politikave dhe mbikqyrjen .....	50
7.3 Zbatimi i programeve dhe shërbimeve për NVM .....	50
7.4 Zbatimi dhe vlerësimi i strategjisë .....	54
7.5 Mekanizmat për koordinimin e donatorëve .....	54
<b>8 Korniza për monitorim dhe vlerësim .....</b>	<b>55</b>
8.1 Korniza për monitorim dhe vlerësim të nivelit të lartë .....	55
8.2 Korniza për monitorim dhe vlerësim në nivel të programeve .....	56
8.2.1 Shtylla 1: Mjedis i favorshëm afarist .....	56
8.2.2 Shtylla 2: Sektor produktiv dhe konkurrues i NVM-së .....	58
8.2.3 Shtylla 3: Ekosistem dinamik i ndërmarrjeve dhe inovacioneve .....	61
<b>PJESA 2: PLAN I VEPRIMIT (2017-2020) .....</b>	<b>63</b>

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

1	Hyrje dhe pasqyrë e shkurtër e Strategjisë.....	63
2	Shtyllat dhe aktivitetet e programore .....	65
3	Buxhet mbi strategjinë dhe planine punës: 2018-2020 .....	94

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Lista e shkurtesave

AMSRM	Agjencia e Mbështetjes së Sipërmarrësisë
ANV	Akti i Ndërmarrjeve të Vogla (KE)
BE	Bashkimi Evropian
EESE	Vlerësimi i Ambientit të Favorshëm për Ndërmarrje të Qëndrueshme
HZH	Hulumtim dhe Zhvillim
KBM	Konfederata e Biznesit e Maqedonisë
KE	Komisioni Evropian
KKIS	Komiteti Kombëtar i Inovacionit dhe Sipërmarrësisë
MKD	Denari i Maqedonisë
NMVM	Ndërmarrjet Mikro, të Vogla dhe të Mesme
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OBEZH	Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Zhvillimit
OJQ	Organizatë Joqeveritare
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OPM	Organizata e Punëdhënësve të Maqedonisë
PBB	Produkti Bruto i Brendshëm
Qeveria	Qeveria e Republikës së Maqedonisë
SEE2020	Strategjia e Evropës Juglindore 2020
SHZHA	Shërbimet për Zhvillim Afarist
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
VNL	Vlerësimi i Ndikimit të Legjislacionit

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Strategjia e NVM në pika të shkurtëra

*“NVM-të konkurrueshme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Vizioni i Strategjisë: NVM-të e konkurrueshme të Maqedonisë janë shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse dhe të krijimit të vendeve të punës produktive dhe dinjitoze.

Objektivi i përgjithshëm i Strategjisë: Strategjia e NVM po definon një kornizë bashkëpunimi midis vepruesve të sektorit publik dhe privat dhe shoqërisë civile, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të NVM dhe inovacionit, në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së tyre.

Objektivat strategjikë:

1. **Mjedisi i volitshëm afarist:** Të krijohet një ambient i favorshëm afarist, brenda të të cilit inkurajohen sipërmarrësit dhe investimet.
2. **Sektor i produktiv dhe i konkurrueshëm i NVM:** Të ndihmohen NVM për t'u bërë pjesëmarrës me produktivitet të lart dhe të konkurrueshëm në tregun evropian, si dhe në tregjet tjera ndërkombëtare.

**Eko-sistemi dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacioneve:** Të inkurajohet konkurrueshmëria ekonomike me anë të rritjes së kapacitetit sipërmarrës dhe inovativ i NVM.

NVM-të konkurruese maqedonase janë shtytës të rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të krijimit të vendeve të punës produktive dhe të denja		
SHTYLLA 1 Mjedisi i volitshëm afarist	SHTYLLA 2 Sektor konkurrues dhe produktiv i NVM	SHTYLLA 3 Eko - sistem dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacionit
PROGRAME	PROGRAME	PROGRAME
Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit thjeshtësimi i	Përmirësimi i shërbimeve në zhvillimin afarist	Zgjerimi i sipërmarrësisë në arsim dhe trajnim Përmirësimi i shkencës, teknologjisë

**“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”**

mjedisit ligjor dhe rregullator	Përmirësimi i qasjes në financa	dhe inovacionit në zhvillimin e NVM
Përforcimi dhe institucionalizimi i dialogut social	Lehtësimi i internacionalizmit	Formimi i parqeve shkencore dhe teknologjike dhe inkubatorëve për inovacion
Koordinimi i të dhënave për NVM, monitorim dhe vlerësim	Mbështetje e zhvillimit të zinxhirit të vlerës	
Shoqata kombëtare e NVM		

**Harmonizim me Aktin për ndërmarrjetevogla të Bashkimit Evropian**

Strategjia e NVM është përgatitur në mbështetje të Aktitndërmarrjeve të vogla (ANV) të Bashkimit Evropian. Në mbështetje të ANV, Strategjia për NVM do të:

- ***Krijojë mjedis në të cilin ndërmarrësit dhe bizneset familjare mund të prosperojnë me çka do të shpërblehet ndërmarrësit.*** do të krijojnë mjedis të favorshëm afarist për të gjitha NVM-të, duke përfshirë edhe ndërmarrjet familjare nëpërmjet një kornizete thjeshtësuar ligjore dhe rregullatore (Programi 1.2), miratim të ligjit të ri për NVM dhe rishqyrtim të Ligjit mbi themelimin e Agjencisë për mbështetje të sipërmarrësisë në Republikën e Maqedonisë, përmirësim të krijimit të politikave dhe koordinimit (Programi 1.1), si dhe përmirësim të shërbimeve për zhvillim afarist (Programi 2.1) dhe qasje më të mirë në financa (2.2).
- ***Sigurojë që, sipërmarrësit e sinqertë të cilët kanë qenë subjekt i falimentimit shumë shpejt marrin një mundësi të re:*** Strategjia do t'i përmirësojë procedurat e falimentimit dhe do të prezantojë fushatë informative mbi promovimin e mundësisë së dytë për sipërmarrësit të cilët më parë kanë dështuar (Programi 1.2).
- **Koncepton rregullat në mbështetje të parimit "Mendo së pari për të voglat":** kjo do të sjell një instrument të veçantë për vlerësimin e ndikimit rregullator, i njohur si Test i NVM për të analizuar efektet e teksteve të të gjitha propozimeve legjislative në lidhje me NVM-të (Programi 1.2).



*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

- **Mundësojë që administrata shtetërore të qëndrojë në dispozicion për të përmbushur nevojat e NVM:** kjo do të përmirësojë krijimin e politikave dhe koordinimin brenda sektorit të NVM (Programi 1.1), do të përmirësojë dialogun social (Programi 1.3), të dhënat dhe analizat për sektorin e NVM (Programi 1.4), do të përforcojë përfaqësimin e sektorit të NVM (Programi 1.5) dhe do të rrisë ndikimin e shërbimeve afariste dhe financiare nëpërmjet krijimit të online Portal-it për NVM (Programet 2.1 dhe 2.2).
- **Lehtësojë qasjen në financa për ndërmarrjet e vogla dhe do të zhvillojë një mjedis ligjor dhe afarist që mbështet pagesën në kohë në transaksionet tregtare:** kjo do të përmirësojë qasjen ndaj financave nëpërmjet krijimit të një regjistri të pasurisë së luajtshme, futjen e faktorizimit, rivitalizimit të skemës së garancisë të kredisë dhe përmirësimin e njohurive financiare (Programi 2.2).
- **Ndihmojë NVM-të që të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga tregu i vetëm i BE-së:** strategjia do të përforcojë lidhjet me programet e BE-së për mbështjen e NVM (Programi 2.1), njëkohësisht do të përmirësojë dhe qasjen e NVM në shërbimet qeveritare për promovim të eksportit (Programi 2.3) duke zhvilluar zinxhirët e vlerave strategjik dhe industrial dhe grupimet (Programi 2.4).
- **Promovojë përsosjen e aftësive në NVM dhe të të gjitha formave të inovacionit:** strategjia do të përfshijë sipërmarrësinë në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit (Programi 3.1), do të mbështesë inovacionin në sektorin e NVM duke mundësuar krijimin e rrjeteve më të mira nëpërmjet komunitetit akademik dhe industrisë, duke përfshirë mbështetjen për HZH (Programi 3.2) dhe formimin e parqeve të reja shkencore, teknologjike dhe inkubatorët për inovacion (Programi 3.3).
- **Aftësoj NVM që sfidat ekologjike t'i shndërrojë në mundësi afariste:** strategjia do të mbështesë zhvillimin e "NVM-ve të gjelbërta" (Programi 2.4).
- **Inkurajon dhe mbështet NVM në shfrytëzimin e rritjes së tregjeve ndërkombëtare:** strategjia do të promovojë një sektor më produktiv dhe konkurrues të NVM duke siguruar mbështetje më të madhe në përmirësimin e ndërkombëtarizimit të sektorit të NVM-së, icili do të përfshijë qasje më të madhe në shërbimet mbështetëse për promovimin e eksportit (Programi 2.3) dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerave strategjik dhe industrial dhe grupimet (Programi 2.4).

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

## PJESA 1: STRATEGJIA

### 1 Hyrje

Korniza kombëtaree politikavepër zhvillimin ekonomik dhe industrial në Republikën e Maqedonisë, përfshirë mbështetjen mbi sipërmarrësinë, inovacionin dhe konkurrueshmërinë, përcakton kontekstin në të cilin është përgatitur Strategjia e NVM. Ky kontekst është përcaktuar, gjithashtu nga korniza më e gjerë evropiane politikave për zhvillim ekonomik, avancimin e ndërmarrjeve të vogla dhe ndërmarrësisë.

#### 1.1 Konteksti i politikës ndërkombëtare

Strategjia është përgatitur me qëllim që të mbështes ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) maqedonase për t'u bërë më konkurrense në ekonominë botërore gjithnjë e më të integruar. Kjo është harmonizuar me një seri të kornizave të rëndësishme të politikës ndërkombëtare.

Përmes **Agjendës së Lisbonës** (2000), Bashkimi Evropian (BE) përcaktoi një objektiv të ri strategjik për t'u bërë "ekonomia më konkurruese dhe më dinamike në botë e cilabazohet në diturinë dhe është e aftë për rritje të qëndrueshme ekonomike me më shumë vende pune të mira dhe kohezion më të madh social". Agjenda fokusohet në përgatitjet për kalim në ekonomi dhe shoqëri të cilat bazohen në diturinë, nëpërmjet politikave më të mira për shoqërinë informatike dhe për hulumtim dhe zhvillim (HZH). Agjenda synon ndaj modernizimit të modelit evropian social nëpërmjet investimit në resurset njerëzore dhe luftës kundër përjashtimit social. Kjo mbështet mirëmbajtjen e perspektivës së mirë ekonomike dhe pikëpamjet më të favorshme të rritjes duke zbatuar kombinimin përkatës të politikave makroekonomike.

**Akti i BE-së për ndërmarrjet e vogla** (viti 2011) paraqet kornizë gjithëpërfshirëse për politikën e NVM në BE. Ky dokument ka për qëllim të përmirësojë qasjen ndaj sipërmarrësisë në Evropë, të thjeshtësojë mjediset e rregullore dhe politikave për NVM dhe të eliminojë pengesat e mbetura për zhvillimin e tyre. Sa i përket dokumentit evropian për ndërmarrje të vogla (viti 2000), ANV përcakton prioritetet e mëposhtme: avancim të ndërmarrësisë, reduktim të ngarkesës rregullatore, përmirësim të qasjes ndaj financave dhe përmirësim të qasjes së NVM në tregjet ndërkombëtarizim. ANV zbaton parimin **“Mendo së pari për të voglat”**, sipas të cilit interesat e NVM merren parasysh në fazat e hershme në krijimin e politikave. Kjo i ndihmon BE-së dhe vendeve të saj – anëtare të përgatitjes legjislacioni i cili është i orientuar drejt NVM-së. ANV është reviduar në vitin 2011 dhe është kryer

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

vlerësimii progresittë arritur në zbatimin e tij në BE. Revizioni i ANV është synuarndaj integrimittë ANVnë strategjinë Europa 2020. Kjo do të përfshijë shndërrimin e strategjisë në specializim të zgjuar (SMART specialisation Strategjia) realisht për NVM evropiane, duke i përkushtuar vëmendje të veçantë nevojave të financimit të NVM-së, përdorimittë hyrjessë përgjithshme drejt përforsimit të qasjes në tregjet e NVM, ndihmesësë NVM të kontribuojnë në ekonominëe cila në mënyrë efektive i përdor resurset dhe avancimin e sipërmarrësisë, hapjen e vendeve të punës dhe rritjen gjithëpërfshirëse.

Republika e Maqedonisë fitoi **statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE**, e cila ka implikime të mëdha lidhurme strategjinë dhe programin për NVM në raport me përsheptimine harmonizimit të legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe nevojën e zbatimit të dokumentit të reviduar Evropian për ndërmarrjet e vogla. Iniciativat e reja, siç janë, Instrumenti për ndihmëne para-anëtarësimittë dhe Programi kornizë i BE-së për konkurrencë dhe inovacion (më parë 2007-2013, aktuale 2014-2020) paraqesin sfida të reja dhe mundësi në raport me shkencën, teknologjinë dhe inovacionin si dhe teknologjinë informatike të komunikimit (TIK) si mjete për rritjen e konkurrueshmërisënë NVM.

StrategjiaEvropa 2020 përcakton vizionin e ekonomisë evropiane të tregut social për shekullinXXI. Strategjia “Evropa 2020” propozon tre prioritete që me njëri tjetrin plotësohen: në rritje të zgjuar (gjegjesisht, zhvillim të ekonomisë që bazohet në dituri dhe inovacion), rritje të qëndrueshme (gjegjesisht,promovim të ekonomisëqë në mënyrë efikase i përdor resurset, që është më e gjelbërt dhe më konkurruese) dhe rritje gjithëpërfshirëse (gjegjesisht,inkurajimin e ekonomisë me një nivel të lartë të punësimit e cila siguron kohezion social dhe territorial).Bazuar në "Europa 2020", vendet e Ballkanit Perëndimor të përfshira në proceset e para-pranimittë përgatitën, gjithashtu **Strategji për Evropën Juglindore 2020** (SEJ 2020), e cila përfaqësonnjë pasqyrimnë vendosmërinë e të gjitha qeverive në Evropën Juglindore për pranimin e qasjeve të guximshme në politikat të cilat janë të domosdoshme për arritjen erritjes së nevojshme ekonomike dhe sociale për përmirësimin e prosperitetit të të gjithë qytetarëve të saj dhe lehtësimin eventual të integrimittë në BE. Në dy dekadat e fundit, shënohet një progres dhe arritje të mëdha dhe të rëndësishme në Evropën Juglindore. Megjithatë, rajoni ende përballet me sfida të caktuara serioze. Strategjia “EJL 2020”e njeh nevojën për bashkëpunim rajonal në fushat epërzgjedhura për t’u ballafaquar me këto sfida dhe përsheptimin e arritjessëobjektivave të zhvillimit në sektoret kryesorë.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Përfundimisht, **Plani aksionar Sipërmarrës 2020** i BE-së paraqet plan për një aksion të përbashkët vendimtar mbi shfrytëzimin potencialit sipërmarrës të Evropës, eliminimin e pengesave ekzistuese dhe revolucionarizimin kulturësë ndërmarrësisë në Evropë. Kjo ka për qëllim të lehtësojë hapjen e ndërmarrjeve të reja dhe të krijojë një mjedis të favorshëm për avancimin dhe rritjen e sipërmarrësve ekzistues. Plani aksionar mbështet arsimimin dhe trajnimin për sipërmarrësi në rritjen dhe hapjen e ndërmarrjeve të reja, fuqizimin kushteve kornizë për sipërmarrësit nëpërmjet eliminimit të barrierave ekzistuese strukturore dhe mbështetjen e tyre në fazat vendimtare të ciklit afarist si dhe ndriçimin e kulturës së ndërmarrësisë në Evropë: mbështetje e brezit të ri sipërmarrës<sup>1</sup>.

## 1.2 Kontekst i politikës kombëtare

Republika e Maqedonisë ka krijuar një kornizë të detajuar dhe strategji të politikës së zhvillimit ekonomike dhe industriale që formon politikën dhe programet publike për zhvillimin e NVM-së.

### 1.2.1 Kornizë e politikës ekonomike dhe industriale

**Programi i reformave ekonomike** (2017-2019) përbëhet nga një kornizë makroekonomike dhe fiskale afatmesme si dhe nga 19 reforma strukturore sektoriale që janë të nevojshme për përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe rritjes. Këto reforma, para së gjithash janë kahëzuar ndaj: lidhshmërisë së kualifikimeve nevojat e tregut të punës, krijimit të ekonomisë udhëhequr nga inovacioni dhe teknologjia, avancim të NVM-së, përmirësim të bashkëpunimit ndërmjet industrisë dhe universiteteve, lidhshmërisë rajonale nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës të transportit, përmirësim të performancave në sektorin energjetik, tejkalim të vështirësive ndërkufitare, shfrytëzimit të potencialit të sektorit bujqësor, turizmit dhe teknologjisë së IT-së.

**Politika industriale** (2009-2020) përcakton vizionin e sektorit industrial i cili është i orientuar drejt "produkteve dhe shërbimeve me vlerë të shtuar më të lartë, bazuar në njohuritë, inovacionin dhe bashkëpunimin reciprok". Ky vizion bazohet në zhvillimin e aftësive për "hulumtime të zbatuara dhe prodhim të produkteve dhe shërbimeve të teknologjisë së lartë të qëndrueshme, organike

<sup>1</sup> *Komisioni Evropian (2013) Planii veprimi për zhvillimin e sipërmarrësisë në BE 2020; Ri – zgjimin e sipërmarrësisë në Evropë*, lajmërim nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit ekonomik – social dhe Komitetit të rajoneve. Bruksel 9.1.2013 COM(2012)795

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

dhe të specializuar që plotësojnë nevojat e tregjeve të segmentuara (të veçanta) ndërkombëtare". Deri në vitin 2020, Republika e Maqedonisë do të zhvillojë një lidhshmëri dinamike të industrive të qëndrueshme dhe autentike, të tilla si: vera dhe ushqimi organik, eko-çeliku, ndërtimi ekologjik, TIK, pjesë të specializuara elektronike, prodhimi i energjisë së rinovuar, industriakreative, pajisje mjekësore, turizëm autentik dhe industri të tjera.

Politika industriale thekson rëndësinë e NVM dhe sipërmarrësisë për rritjen e neto rritjes nëpërmjet një financimi më të mirë dhe krijimit të mjedisitafarist që nxisin frymën sipërmarrëse, të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe promovimin e inovacioneve. Kjo mbështet përforcimin e zinxhirëve global për furnizim nëpërmjet partneriteteve më të mira me eksportuesit e mëdhenj. Objektivi kryesor i kësaj mase është përmirësimi i aftësive konkurruese të furnizuesve vendas të NVM-ve dhe përshpejtimi i bashkëpunimit ndërmjet firmave të mëdhaorientuara dhe furnizuesve vendas. Kjo është në mbështetje të Politikës së integruar industriale të BE-së, e cila paraqet qasje të re ndaj politikës industriale me çka e kahëzon ekonominë drejt rritjes dinamike nëpërmjet përforcimit të konkurrueshmërisë, sigurimit të rritjes dhe vendeve të punës dhe transferimit ndaj një ekonomie me karbon të ulët duke shfrytëzuar resurset në mënyrë efikase. Kjo arrihet nëpërmjet bashkimit të bazës horizontale dhe zbatimin sektorial, njëkohësisht duke shqyrtuar tërë zinxhirin e vlerës dhe zinxhirin e furnizimit<sup>2</sup>. Qeveria e Republikës së Maqedonisë (Qeveria) gjithashtu është e harmonizuar me Strategjinë e politikave industriale të BE-së, e cila çon ndaj një sektor industrial më të fuqishëm evropian për rritje dhe rimëkëmbje ekonomike. Kjo përfshijet të përcaktojë një vizion gjithëpërfshirës, duke u fokusuar në investimet, inovacionet dhe njëkohësisht duke mobilizuar të gjitha mjetet në dispozicion për përmirësimin e tregtisë dhe konkurrueshmërisë së NVM<sup>3</sup>.

**Master plani për përmirësimin e konkurrueshmërisë (2015-2018)** monitoron strukturën e 12 shtyllave të Indeksit global të konkurrueshmërisë të Forumit ekonomik botëror dhe identifikon 111 faktorë ose çështje specifike. Master plani në mënyrë plotësuese shqyrton çdo faktor/çështje. **Strategjia për**

<sup>2</sup> Komisioni Evropian (2010) *Politika industriale për epokën e globalizimit – Fokusimi i konkurrencës dhe qëndrueshmërisë*, Lajmërim nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit ekonomik – social dhe Komitetit të rajoneve. Bruksel 28.10.2010 SEC(2010)1272

<sup>3</sup> Komisioni Evropian (2012) *Industri më e fuqishme evropiane për rritje dhe rimëkëmbje ekonomike*, Këshilli, Komiteti ekonomik – social dhe Komiteti rajonal. Bruksel, 28.10.2010 SWD(2012)297

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

**konkurrueshmëri me një plan veprimi**(2016-2020) ka për qëllim të "përforcojë mjedisin ligjor, institucional dhe kërkimor për punë afariste, duke përfshirë edhe zbatimin e legjislacionit të BE-së (acquis)për tregun e brendshëm;përmirësimin e konkurrueshmërisë dhe inovacioniet në ekonomi, në nivel kombëtar dhe lokal; rritjen e drejtpërdrejtë të investimeve të huaja; rritjen e aktiviteteve në hulumtime dhe zhvillim; rritjen e eksportit dhe diversifikimit; dhe mbështetjen për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe konvergjencë reale me BE-në. "Një nga shtatë shtyllat e saja strategjike është krijimi i një" sektori ndërmarrës dhe më produktiv i NVM-së".

**Strategjia kombëtare e inovacionit** (2012-2020) synon ndaj fillimittë transformimittë vendit në një ekonomi të bazuar në njohuri e cila është e aftë të jetë e konkurrueshme në tregjet ndërkombëtare nëpërmjet fuqisë punëtore të trajnuar dhe ndërmarrjeve inovative. Kjoi njeh inovacionet si shtytës kryesore të rritjes ekonomike dhe ka për qëllim të nxisë konkurrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik në bazëtë njohurive dhe inovacionit.Strategjia,gjithashtu ka për qëllim të sigurojë se, deri në vitin 2020 Maqedonia do të zotërojë një sistem efektiv kombëtar për inovacione i cili është krijuar së bashku me të gjithë aktorët dhe është i hapur për botën. Kjo do të arrihet nëpërmjet përforcimit të prirjes në sektorin e biznesit për regjistrimin e inovacioneve; përforcimin e resurseve njerëzore për inovacion; krijimin e mjedisit rregullator për mbështjen e inovacionit; dhe rritjen njohurive rrjedhëse ndërmjet aktorëve në inovacionit.

**Programi për inkurajimin e investimeve në Republikën e Maqedonisë** (2011-2014) ka për qëllim të zhvillojë politika dhe të zbatojë reforma që do të çojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik më dinamik, nëpërmjet rritjes së atraktivitetit të vendit për investitorët vendas dhe të huaj. Programi ka kontribuar në përmirësimin e klimës së përgjithshme afariste dhe investuese nëpërmjet politikave më të qëndrueshme makroekonomike dhe fiskale, përmirësimine politikave tatimore, doganore dhe mbështetjene NVM.

**Strategjia për promovimin e eksportit** (2011-2013) shënon rrugën ndrejt rritjes së vlerës të eksportit të gjeneruar nga kompanitë maqedonase të USD 1,12 miliardë dollarë të USD 1,45 miliardë dollarë. Kjo fokusohet në katër sektorë industrialë: tekstil dhe veshëmbathje, agrobiznes dhe industri ushqimore, industria metalike dhe mekanikëprecize dhe TIK.

**Strategjia e mësimi të sipërmarrësisë** (2013-2020) ka për qëllim që të përmirësojë konkurrueshmërinë e NVM-së, posaçërisht ndaj atyre të drejtuara nga persona të rinj dhe gratë - për konkurrueshmëritë suksesshme në tregjet e

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

BE-së. Strategjia do ta arrijë këtë duke përmirësuar shkathtësitë për punësim dhe kompetencat sipërmarrëse të personave të rinj dhe duke përforcuar frymën sipërmarrëse nëpërmjet parimeve për mësim gjatë tërë jetës të cilat janë përsosur në të gjitha segmentet e sistemit arsimor.

### 1.2.2 Kornizë politike e NVM

Kjo strategji përfaqësonnjë kapitull të fundit në një seri ndërhyrjesh të suksesshme të politikave që janë synuarndaj mbështetjës të zhvillimit dhe konkurrueshmërisë së sektorit të NVM në mbarë vendin. Kjo strategji parashikonmjete nëpërmjet të cilave Republika e Maqedonisë mund të punojë me sektorin privat dhe me komunitetin ndërkombëtarë, duke përfshirë Kombet e Bashkuara dhe Komisionin Evropian (KE), Bankën Botërore dhe partnerët e tjerë ndërkombëtarë, për të inkurajuar zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik.

Përgatitja e politikave të NVM në Republikën e Maqedonisë filloi në vitin 2002. Kjo ishte periudha kur qeveria nënshkroi memorandumun me KE-në për pjesëmarrje në Dokumentin evropian për ndërmarrjete vogla. Të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor pranuan obligimet e Dokumentit. Pikërisht për këtë bazë Ministria e Ekonomisë përgatiti **Strategjinë e parë Kombëtare për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme** (2002-2013) e cila përfshin "Program për masat dhe aktivitetet për mbështetjen e zhvillimit të sipërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë të ndërmarrjeve të vogla në periudhën nga viti 2003 deri në vitin 2006". Kjo strategji është reviduar në vitin 2007 dhe është sjell Program i ri për zhvillimin e ndërmarrësisë, konkurrueshmërisë dhe inovacionit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (2007-2010).

Programi i masave dhe aktiviteteve për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë së NVM (2002-2006) është përgatitur si një dokument shoqëruës për strategjinë e parë kombëtare të NVM-së. Programi përcakton prioritetet mbi përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe suksesin e sektorit të NVM-së, duke u fokusuar në:

- Krijimin e një infrastrukture institucionale për avancimin e sipërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë;
- Krijimin e një ambienti të favorshëm ekonomik dhe përmirësimin e nivelit të lirisë ekonomike;
- Promovimin e sipërmarrësisë dhe mbështetjen e formave jofinanciare;
- Sigurimin e formave financiare të mbështetjes për zhvillimin e sipërmarrësisë; dhe

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

- Zbatimin e programit për krijimin e konkurrueshmërisë.

Në vitin 2006, strategjia e NVM është riveduar: **Rivolidimi i strategjisë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme** (2002-2013) kishte për qëllim të kontribuojë ndaj rritjes së përgjithshme të punësimit në sektorin e NVM dhe pjesëmarrjen e tyre në Bruto prodhimin vendor (BPV) deri në fund të vitit 2013. Matja bëhet nëpërmjet rritjes së numrit të NVM, numrit të personave të punësuar në NVM dhe vlerës së kontributit të NVM në krijimin e BPV. Revizioni është kryer që t’u përgjigjet sfidave të reja dhe të ardhshme në sektorin e NVM, duke përfshirë nevojën për të siguruar harmonizime të kërkesave nga legjislacioni i zbatuar Bashkimit (*Acquis Communautaire*), posaçërisht me ato që i dedikohen NVM si dhe të krijohet fokusi i ri lidhur me çështjet, të tilla si sipërmarrësia, inovacionet dhe TIK, që ishin pjesë përbërëse e Programit kornizë për konkurrueshmëri dhe inovacionet BE-së (2007-2013). Strategjia e riveduar kishte këto objektiva:

- Përmirësimi i krijimit të politikave;
- Thjeshtësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator;
- Përmirësimi ndaj qasjes në financa;
- Thjeshtësimi i taksave;
- Promovimi i teknologjisë informatike dhe komunikimit;
- Përforsimi i shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në funksion të zhvillimit të NVM;
- Promovimi i sipërmarrësisë në arsimim dhe trajnim;
- Inkurajimi i ndërkombëtarizimit të NVM;
- Përmirësimi i shërbimeve të zhvillimit afarist; dhe
- Fuqizimi i dialogut ndërmjet sektorit publik dhe privat.

Strategjia kombëtare e NVM (2017-2022) përmirëson arritjet e strategjisë së mëparshme. Kjo vazhdon përpjekjet për përmirësimin e mjedisit afarist për zhvillimin e NVM, njëkohësisht duke fuqizuar përpjekjet për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe inovacionin. Për këtë arsye, strategjia ka për qëllim të ruajë ritmin e reformave të arritura nga Qeveria dhe të thellojë këto reforma çdo herë që të jetë e mundur.

Republika e Maqedonisë ka shënuar arritje të rëndësishme në reformat e saj ekonomike dhe afariste. Banka Botërore renditi Maqedoninë në vendin e dhjetë në botë sipas Indeksit për lehtësim gjatë udhëheqjes së biznesit (*Udhëheqja e biznesit në vitin 2017*), gjë e cila paraqet ngritje prej gjashtë vendeve në krahasim me vitin e kaluar. Sipas Indeksit global për konkurrueshmërinë e Forumit ekonomik botëror, ekonomia maqedonase në vitin 2015-16



***“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”***

radhitet në vendin e 60-të, që paraqet një ngritje të rëndësishme në krahasim me vendin e 80-të në 2012-13.

Pasqyra e fundit e Indeksit të politikave ekonomike në fushën e NVM në BE (Organizata për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OBEZH) 2016) vlerësoi Maqedoninë për kornizën e saj institucionale dhe mjedisin operativ, me çka Vendi konsiderohet si "një nga ekonomitë më të avancuara në rajonin e Evropës Juglindore në raport të avancimit të sektorit të NVM". Kjo pasqyrë inkurajon Maqedoninë të vazhdojë programin e saj reformues dhe të sigurojë ofrimin adekuat të shërbimeve që plotësojnë nevojat e NVM. Pasqyra përmban edhe propozime për përmirësimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve të NVM dhe për mbështetjen e diversifikimit të burimeve jo-bankare të financave.

Në mars të vitit 2016, Enti shtetëror për revizion lëshoi një raport mbi zhvillimin dhe mbështetjen e NVM i cili fokusohet në dispozitat lidhur me zhvillimin e NVM në politika dhe legjislacion si dhe në ndikimin e programeve financiare dhe programeve për zhvillimin e resurseve njerëzore. Ky raport rekomandon përmirësim në:

- **Koordinimi i NVM:** harmonizimi të legjislacionit, posaçërisht të Ligjit për Agjencinë për mbështetje të sipërmarrësisë (AMSRM) dhe Ligjit për shoqëritë tregtare, për zbatimin e klasifikimit unik të NVM dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të institucioneve që zbatojnë masat ndihmëse shtetërore dhe mbështetëse; përmirësimi të komunikimit nëpërmjet krijimit të politikave dhe zhvillimit të programeve të NVM në nivel qendror dhe lokal; dhe zhvillimin e politikave strategjike për sipërmarrësi, mbështetje dhe zhvillim të NVM;
- **Përdorimi i efikas i resurseve:** analizimi të roleve, funksioneve dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të agjencive për mbështetje të NVM; përmirësimi të komunikimit ndërmjet agjencive qendrore dhe lokale për zhvillimin e NVM; dhe kurkjo nevojitet, zgjerimi i asortimentit të shërbimeve për zhvillimin e NVM; dhe
- **Monitorimi dhe vlerësimi:** Krijimi i sistemit të integruar për menaxhim me suksesin, i cili përfshin monitorimin dhe vlerësimin pjesëmarrës të NVM në indikatorët makroekonomikë (p.sh. BPV, eksport, fuqia punëtore, produktiviteti).

Këto rekomandime sigurojnë informacione përkatëse për formulimin e strategjisë aktuale. Informacione të tillajane sigurohen edhe nga rezultatet e

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

anketave të fundit dhe konsultimeve me NVM të përshkruara në kapitullin vijues.

## 2 Profili i NVM dhe sfidat

Strategjia e NVM ka për qëllim që t’i përgjigjet sfidave kritike dhe çështjeve me të cilat përballet sektori i NVMnë Republikën e Maqedonisë. Vitete fundit janë kryer një sërë evaulime të ndryshme kombëtare të sektorit të NVM, paralelisht me evaulimet e tjera ndërkombëtare. Konstatimet nga këto vlerësime siguruan informacione mbi rividimin e politikave dhe strategjive qeveritare për zhvillimin e NVM në tërë vendin<sup>4</sup>. Këtu përfshihet edhe anketa kombëtare e NVM e cila është realizuar gjatë përgatitjes së kësaj Strategjie (MOT2016).

### 2.1 Definicioni për NVM

Në Republikën e Maqedonisë nuk ekziston ndonjë definicion për NVM. Në Ligjin e shoqërive tregtare të vitit 2004, në pjesën për libra tregtarë, llogari vjetore dhe raporte financiare, me nenin 470 klasifikohen tregtarët e mëdhenj, të mesëm, të vegjël dhe mikro tregtarët, në aspektin eudhëheqjes së kontabilitetit. Ky definicion është harmonizuar me definicionin e BE-së (Rekomandimi i BE-së 2003/361) në raport të pragjeve për numrin e të punësuarve, por jo edhe me pragjet e të ardhurave vjetore dhe bilancit të gjendjes. Gjithashtu, agjenci të ndryshme kanë grupe synuese të ndryshme për shërbimet e tyre. Për shembull, Ligji për themelimin e AMSRM (gjegjësisht Ligji për themelimin e Agjencisë së NVM të Republikës së Maqedonisë) identifikon NVM si ndërmarrje të pavarura që kanë më pak se 50 të punësuar, realizojnë gjithsej qarkullim vjetor i cili nuk tejkalon 1,5 milion euro, të shprehura në denarë dhe janë të paktën 51 për qind në pronësi private (Neni 3).

**Figura 1: Definicioni i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme**

Madhësia e shoqërisë	Definicioni i BE-së	Ligji për shoqëritë tregtare viti 2004 (I ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2013)
Mikro	<10 të punësuar	<10 të punësuar

**Comment [D1]:** Анализа на трите закони. Споредбена табела.

<sup>4</sup> Ato përfshijnë: MOT (2013) *Vlerësimi i mjedisit të favorshëm për sipërmarrësi të qëndrueshme; Maqedoni*; MOT (2016) *Anketa kombëtare e NVM-së; OECD (2016) Indeksi i Politikave të NVM-së; Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2016; Vlerësimi i zbatimit të Aktit të ndërmarrjeve të vogla për Europën; Enti shtetëror për revizion (2016) Raport mbi efikasitetin e sistemit për krijimin dhe zbatimin e politikave, masave dhe aktiviteteve që lidhen me zhvillimin e NVM-së dhe mbështetjen për NVM-të; Banka Botërore (2013) *Maqedonia, Profili i vendit; Sondazhet e ndërmarrjeve; Banka Botërore (2016) Udhëheqja e biznesit në Maqedoni; Forumi Ekonomik Botëror (2016) Indeksi i Konkurrencës Globale 2016-17; Maqedonia.**

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	≤2 milion euro qarkullim apo bilanci i gjendjes	≤50.000 eurobruto të ardhura vjetore, të shprehura në denarë
<b>Të vogla</b>	10 deri 50 të punësuar 2–10 milion euro qarkullim apo bilanci i gjendjes	≤ 50 të punësuar dhe ≥ 2 milion euro të ardhura vjetore, të shprehura në denarë apo < 2 milion euro qarkullim vjetor (totali aktiv i mjeteve), shprehur në denarë
<b>Të mesme</b>	<250 të punësuar ≤50 milion euro qarkullim ≤43 milion euro bilanci i gjendjes	≤250 të punësuar dhe ≥10 milion euro të ardhura vjetore, të shprehur në denarë apo < 11 milion euro qarkullim vjetor (totali aktiv i mjeteve), shprehur në denarë

BURIMI: Ministria e Ekonomisë (2004) Ligji për shoqëritë tregtare (i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2013), Ministria e Ekonomisë

## 2.2 Profili i NVM

Pavarësisht madhësisë së ndërmarrjeve individuale, sektori i ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në tërësi është dominante në ekonominë maqedonase. Të dhënat e fundit tregojnë se 99,8% e të gjitha ndërmarrjeve takojnë në këtë grup. Në vitin 2013, 53.137 ndërmarrje ishin NMVM, që paraqet zvogëlim në krahasim me 55.385 ndërmarrje në vitin 2009. Siç tregohet në Figurën 2, 91.0% e të gjitha ndërmarrjeve në vend janë ndërmarrje mikro.


NVMN, janë gjithashtu punëdhënësit më të mëdhenj, duke siguruar 76,6% e të gjitha punësimeve. Nga ky aspekt është vërtetuar se mikro ndërmarrjet punësojnë vetëm një të tretën e numrit të përgjithshëm të punëtorëve, përderisa NVM-të së bashku punësojnë 43,0% e të gjithë punëtorëve. Ndërmarrjet e mëdha të pakta që janë në vend me më shumë se 250 të punësuar, ofrojnë punësim për 23,4 përqind të fuqisë punëtore.

Nga këndvështrimi i vlerës së shtuar, kontributi i mikro ndërmarrjeve edhe më tej vazhdon të bjerë. Pavarësisht madhësisë së tyre, mikro ndërmarrjet marrin pjesë me vetëm 24,0% të vlerës së shtuar, përderisa NVM-të marrin pjesë me 43,0%. Ndërmarrjet e mëdha janë gjeneratorët më të mëdhenj të konsiderueshme të vlerës së shtuar (figura 2). Prandaj, sfida kryesore është që t’ju ndihmohet ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të realizojnë rritje dhe të

“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”

kontribuojnë në masë më të madhe ndaj punësimit kombëtar dhe të krijojnë vlerë të shtuar.

Figura2: Treguesit e demografisë së ndërmarrjeve



**Comment [DL2]:** Оваа слика треба да биде направена со превод на македонски јазик, независно од каде е преземена и на каков јазик е напиана

BURIMI: OECD (2016) *Indeksi i Politikave të NVM-së; Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2016; Vlerësimi i zbatimit të Aktit të ndërmarrjeve të vogla për Evropën*, OECD Publishing, Paris

Pjesëta NVM në punësime dhe vlera e shtuar shënojnë rritje të lehtë gjatë periudhës prej vitit 2009 deri në vitin 2013. Ashtu si në ekonomitë e tjera në rajon, shumica e numrit të NVM punojnë në sektorin për tregëti me shumicë dhe pakicë (44,0%), për të cilët pason sektori i prodhimit (13,0%) (OESR 2016).

### 2.2.1 NVM joformal

Një numër i madh mikro bizneseve janë ose persona të vetëpunësuar (punojnë si SHPKNJ ose tregtarë individualnë përputhje me format ligjore të definuara me Ligjin për shoqëri tregtare) ose janë zejtarë. Përveç kësaj, ato ende janë të përfaqësuar në ekonominë joformale, mirëpo me kalimin e kohës, me të gjitha masat që solli Qeveria, mënyra e tyre e punës bëhet e formalizuar. Sondazhi kombëtar i NVM e MOT (2016) përcaktoi arsyen kryesore se përse kompanitë mbesin në ekonominë joformale ose "gri" (dmth. si ndërmarrje të paregjistruara) është ajo se formalizimi është shumë i shtrenjtë. Duket se vendimi për formalizim është i lidhur ngushtë me rritjen: shoqëritë joformale regjistrohen kur shohin perspektiva pozitive të rritjes dhe fillojnë të punësojnë më shumë persona.

Raporti i anketës së MOT (2016) thekson se duhet vënë theks mbi formalizimin e ekonomisë joformale, jo vetëm në lidhje me regjistrimin, taksimin dhe kuadrin

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

juridik dhe rregullator, por edhe në raport me stimulimin dhe mbështetjen e avancimit të produktivitetit dhe punësimit. Formalizimi ofron shumë përfitime, duke përfshirë qasjen në një numër të madh të shërbimeve për mbështetjen e punës së tyre.

## 2.2 Sfidat kryesore

### 2.2.1 Mjedisi afarist

Maqedonia ka një mjedis relativisht të mirë afarist, me hapësirë për përmirësim të mëtejshëm. Raporti *“Udhëheqjae biznesit”* e Bankës Botërore (2017) e rradhit Maqedoninë në vendin e 10-të sipas Indeksit për lehtësimin e udhëheqjes së biznesit. Në fakt, vendi është i katërti në botë sa i përket lehtësisë për fillimin e një biznesi. Sipas indeksit për regjistrimin dhe pagesën e tatimeve, Maqedonia është ranguar në vendin e nëntë në botë.

### E drejta e punës

Anketa kombëtare për NVM-në e MOT (2016) konstatoi se e drejta e punës paraqet një çështje të rëndësishme për një numër të madh të punëdhënësve nga sektori privat. Përafërsisht 91,0% e të gjitha ndërmarrjeve janë përgjigjur se kanë lidhur marrëveshje formale me punonjësit e tyre. Megjithatë, shumica e numrit të punësuarve nuk janë të sindikalizuar dhe nuk janë të siguruar nga aksidentet apo lëndimet në vendin e punës.

Përveç kësaj një numër i madh i themeluesve, drejtorëve dhe menaxhmentit të NVM-ve shprehën shqetësim rreth ligjeve nga fusha e të drejtës së punës, duke i **përkrahur ato si ligje që “dekurajojnë rritjen”,** gjegjësisht kushtet e vështira të procedurave administrative në raport të të drejtave të punëtorëve.

Gjithashtu, nga ana e NVM, gjithashtu theksohen edhe inspektimet e shpeshta dhe rigoroze të punës.

### Mosmarrëveshjet tregtare

Qasja në drejtësi dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve tregtare është një sfidë për shumë NVM. Anketa kombëtare për NVM e MOT (2016) zbuloi se shumica e të anketuarve (91,0%) kërkuan këshilla ligjore për një çështje të lidhur me punën afariste. Ekziston mundësia për përmirësime në këtë fushë, veçanërisht përmes zhvillimit të mekanizmave alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

## Falimentimi

Anketa kombëtare për NVM e MOT (2016) zbuloi se vetëm 6,0% e të anketuarve kishin falimentuar në të kaluarën. Kjo ishte paraqitje më e zakonshme në mesin e ndërmarrjeve mikro se në llojet e tjera të ndërmarrjeve. Të dhënat e anketës tregojnë se shumica e themeluesve, drejtorëve dhe menaxhmentit të NVM-ve konsiderojnë se dispozitat rrjedhëse të falimentimit nuk u japin shansin e dytë sipërmarrësve. Edhe pse themelimi i një kompanie është e thjeshtë, mbyllja e një shoqërie është një proces shumë i komplikuar i cili duhet përmirësuar (nëpërmjet shkurtimit të afateve dhe shpenzimeve).

### 2.2.2 Shërbime për zhvillim afarist

Ekzistojnë shumë organizata, programe dhe projekte që mbështesin zhvillimin e NVM. Megjithatë, ato zakonisht sigurohen drejtëpërdrejtë nga Qeveria, partnerët ndërkombëtarë dhe donatorët dhe shumë më pak nga sektori privat. Gjithashtu ekzistojnë një numër i madh i ofruesve të shërbimeve për zhvillim afarist (UDR) nga sektori privat, por shumica e ofrimit të këtyre shërbimeve gjenden në Shkup. Në vitet e fundit, modelet tradicionale për mbështetje të ndërmarrjeve në themelim (strat – up ndërmarrje) dhe rritje (p.sh. trajnimi i aftësive afariste, konkurse për plane afariste) zëvendësohen me modele dhe shërbime të reja të cilat kërkojnë nga ana e NVM siç është ndërkombëtarizimi, vendime inovative për investime në burimet e ripërtërishme të energjisë etj. Trajnimi i ndërmarrjeve përqendrohet në "përsheptimin e biznesit" që ofron trajnim intensiv prej tre deri në katër muaj me gatishmëri për të investuar. Përsheptuesit aktualisht përqendrohen në sektorin e TIK në Maqedoni dhe shumica e tyre janë të vendosur në Shkup.

### 2.2.3 Qasje në financa

Një numër i madh i NVM kanë probleme me qasjen në shërbimet financiare. Raporti i KE-së (2016) për Maqedoninë nënvizon se qasja në financa mbetet e vështirë për NVM, duke marrë parasysh pengesat në ofertë, ashtu edhe në kërkesat kredive, pavarësisht likuiditetit të bollshëm të bankave<sup>5</sup>. Ky problem është i përcaktuar në të gjithë vendin. Vlerësimi i mjedisit të favorshëm për

<sup>5</sup> Komisioni Evropian (2016) *Republika e Maqedonisë, Raporti për vitin 2016*; Lajmërim nga Komisioni deri te Parlamenti Evropian, Këshilli, Komiteti socio – ekonomik dhe Komiteti i rajoneve, 2016 Lajmërim për zgjerimin e politikave të BE-së, Dokument pune i shërbimit profesional të Komisionit, 9 nëntor, Bruksel.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

ndërmarrjet e qëndrueshme (POOD) nëMOT(2013) vërtetoi se rritja e NVM është bazuar kryesisht në vetëfinancim, me një preferencë të theksuar të shfrytëzimit të përfitimit të ruajtur ose kapital të ri, privat ose familjar ose kapital nga miqtë. Financimi me huamarrjet nga banka është në nivel të ulët në krahasim me vendet e tjera.Shfrytëzimi i engjëjve të biznesit dhe kapitalit sipërmarrës është në nivel të ulët. Shpenzimet e larta e huasënga banka(kërkesat për sigurimin e normavetë larta të interesit, etj.) janë nënvizuar në anketën e MOT (2016) si një nga problemet më të mëdha për NVM, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla.

#### 2.2.4 Kultura e sipërmarrësisë

Më shumë se një e treta e kompanive të anketuara nga MOT (2016) deklaruan se kishin lëshuar vendin e punës të mëparshëm në sektorin privat për të hapur kompanitë e tyre. Më pak se një e treta ishin të papunë kur filluan biznesin e tyre personal, ndërsa të anketuarit e tjerë të mbetur ishin studentë apo zyrtarë qeveritarë para se të themelonin kompanitë e tyre. Këto shifra nuk ndryshojnë shumë kur bëhet fjalë për burrat apo gratë.

Arsyeja më e shpeshtë për themelimin e një kompanie ishte që ata të bëhen shefa (51,0%); arsyeja e dytë më e shpeshtë ishte fleksibiliteti i punës (30,0%). Në këtë rast, nuk ka ndryshime kur bëhet fjalë për burrat apo gratë.

#### 2.2.5 Produktivitet dhe kushtet e punës

Edukimi dhe trajnimi kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë cila bazohet në dituri dhe në zhvillimin ekonomik në përgjithësi. Nga këndvështrimi i NVM, arsimimi, aftësimi dhe disponueshmëria e aftësive të kërkuara janë faktorë të zhvillimit thelbësorë. Në mënyrë plotësuese, qasja në një fuqi punëtore të kualifikuar është një nga fushat më problematike kur bëhet fjalë për NVM.

#### 2.2.6 Përfaqësim, dialog dhe ndërmjetësim

Anketa kombëtarepër NVM tëMOT (2016) vërtetoi se, gjysma e numrit të përgjithshëm të NVM janë anëtarë të ndonjë organizate afariste apo organizatë të punëdhënësve. Nivelet e anëtarësimit ndryshojnë në varësi të madhësisë së ndërmarrjes: 45,0% mikro ndërmarrje, 58,0% ndërmarrje të vogla dhe 77,0% ndërmarrjetë mesme. Gratë afariste kanë më shumë gjasa të bashkohen me një organizatë afariste apo organizatë të punëdhënësve: 61,0% e të gjithë të anketuarve gra, krahasuar me 44,0% e të anketuarve meshkuj. Shumica e anëtarëve të organizatave afariste ose organizatave të punëdhënësve janë anëtarë pasivë dhe paraqesin një angazhim të vogël të drejtpërdrejtë në aktivitetet e këtyre organizatave.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

### 3 Vizioni, objektivi përgjithshëm dhe objektivat strategjisë

#### 3.1 Vizioni i strategjisë

NVM konkurruese maqedonase janë shtytëse të rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse edhe në krijimin e vendeve të punës produktive dhe të denja.

#### 3.2 Objektivat përgjithshme të strategjisë

Strategjia e NVM krijon një kornizë bashkëpunimi ndërmjet palëve të sektorit publik dhe privat dhe shoqërisë civile me qëllim që të mbështesë zhvillimin e NVM dhe inovacionit në drejtim të përmirësimit të konkurrueshmërisë së tyre.

#### 3.3 Objektivat strategjike

Strategjia për NVM është rishqyrtuar ndaj tre objektiveve strategjike. Ata sigurojnë udhëzime për formulimin e tre shtyllave në bazë të të cilave u organizuan intervenime të veçanta programore. Këto janë paraqitur në vazhdim të këtij dokumenti (shih Kapitullin 5).

##### **Objektivi strategjik 1 - Mjedis i favorshëm afarist:**

Të krijohet një mjedis i favorshëm afarist në të cilin inkurajohen sipërmarrësia dhe investimet.

##### **Objektivi strategjik 2 –Produktivitet dhe konkurrueshmërinë sektorine NVM:**

T’ju ndihmohet NVM në Maqedoni që të bëhen pjesëmarrës produktivë dhe konkurrues në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.

##### **Objektivi strategjik 3 - Ekosistemi dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacionit:**

Të inkurajohet konkurrueshmëria ekonomike e Maqedonisë nëpërmjet rritjes së kapacitetit sipërmarrës dhe inovativ të NVM.

#### 3.4 Grupet e synuara

Përfituesit përfundimtarë të Strategjisë së NVM janë të gjitha ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, si formale dhe joformale, pavarësisht nga sektori dhe industria në të cilën ata punojnë dhe vendndodhja e tyre në kuadër të Republikës së Maqedonisë dhe në mbështetje me kriteret që përcaktojnë mikro të vogla dhe ndërmarrjet e mesme. Prioritet do të paraqesin sektorët dhe industritë ku ekzistojnë perspektiva më të mëdha të rritjes dhe hapjes së vendeve të reja të punës.



*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Në krijimin e Strategjisë dhe politikave për NVM si dhe zbatimin e masave që rrjedhin nga Strategjia për NVM, Qeveria, përmes ministrive të saj dhe institucioneve shtetërore dhe publike do të bashkëpunojë me organizatat komerciale, organizatat e punëdhënësve, sindikatat dhe sektorin joqeveritar, me qëllim që të sigurohet krijimi dhe realizimi më i mirë i politikave dhe masave që dalin nga Strategjia. Bashkëpunimi do të sigurojë transparencë më të madhe, përgatitje të NVM për ndryshime të mundshme në mjedisin afarist dhe qasje më të lehtë në të gjitha shërbimet që janë në dispozicion.

Qeveria mbështet krijimin e një kuadri institucional përmes të cilis do të zbatohen programet dhe shërbimet për zhvillimin e NVM, duke përfshirë UDR dhe shërbimet financiare. Nga këto institucione dhe organizata që veprojnë në këtë kuadër kërkohet që të identifikojnë NVM që do t'i mbështesin dhe t'i informojnë për shërbimet që u ofrojnë atyre.

Në kuadër të sektorit të NVM, vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të grupeve të synuara në vijim:

- **NVMtë orientuara drejt shkallës së lartë të rritjes:** këto ndërmarrje janë themeluar para tre viteve; këto janë kryesisht ndërmarrje të vogla apo të mesme dhe kanë njohuri të mira ndaj tregjeve ku ato punojnë. Me një qasjedrejtllojeve të duhura të UDR dhe shërbimeve financiare, këto ndërmarrje kanë potencial të madh për hapjen e vendeve të punës dhe zgjerimin e tregjeve të BE-së dhe të tregjeve të tjera ndërkombëtare.
- **NVMnë sektoret dhe zinxhirët e vlerës me shkallë të lartë të rritjes:** planet e zhvillimit ekonomik të identifikuar nga sektorët industrial me potencial për rritje të shpejtë, në mënyrë eksplicite duhet t'i përshkruajnë mënyrat në të cilat mund të rriten NVM në këta sektorë. Kjo do të përfshijë strategji për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në zinxhirin e vlerave të sektorëve me shkallë të lartë të rritjes.
- **NVM të lartë inovativ:** një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mbështetjes së zhvillimit të NVM që janë themeluar për të komercializuar produkte të reja inovative, shërbime apo modele afariste. Kjo do të përfshijë partneritetet me universitetet dhe departamentin e HZH.
- **Ndërmarrjet mikro dhe joformale:** burra dhe gra të papunë të cilët janë të detyruar të themelojnë një ndërmarrje me qëllim që të realizojnë mjete financiare për mbijetesë. Këto kompani shpeshherë janë në pronësi familjare dhe zakonisht kanë kapacitet të ulët të përhapjes sepse

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

zakonisht punojnë në tregje të mbingarkuara që ofrojnë të ardhura margjinale. Këtyrëndërmarrje u nevojitet mbështetje për formalizim (gjegjësisht regjistrim) dhe për të gjetur tregje të reja.

- **NVM në pronësi të grave dhe personave të rinj:** Zhvillimi i NVM siguron një mekanizëm të fuqishëm për fuqizimin ekonomik të grupeve shoqërore që shpesh janë të përjashtuar nga pjesëmarrja e plotë në ekonomi dhe tregun e punës, të tillë sigratë dhe personat e rinj. Prandaj, mund të konceptohen programe dhe shërbime për zhvillimin e NVM për mbështetjen e këtyre grupeve.

#### 4 Parimet

Parimet e mëposhtme e përbëjnë bazën e zhvillimit të NVM në Republikën e Maqedonisë:

1. Ministria e Ekonomisë siguron mbikëqyrje dhe udhëheqje në zhvillimin e sektorit të NVM duke koordinuar dhe integruar politikat dhe programet me ministritë kyçe qeveritare, sektoret dhe agjencitë si dhe me organizatat afarsite dhe organizatat e punëdhënësve, sindikatat dhe të gjitha organizatat e tjera përkatëse të shoqërisë civile dhe organizatat joqeveritare (OJO).
2. Zhvillimi i NVM është harmonizuar me planet mbi zhvillim ekonomik të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe me identifikimin e sektorëve të veçantë të rritjes ekonomike.
3. Shërbimet e zhvillimit të NVM rrisin potencialin për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, njëkohësisht duke përkrahur krijimin e vendeve të punës produktive dhe të denjë në sektorin e NVM.
4. Çdoherë kur ajo është e mundur, zbatohen qasjet sistematike, të orientuara kah tregu dhe të qëndrueshme për zhvillimin e NVM në mënyrë që të adresohen përkufizimet kryesore dhe pengesat në sektor dhe të sigurohet se të gjitha NVM shfrytëzojnë përfitimet nga këto investime.
5. E një rëndësie thelbësore është ekzistimi i një mjedisi afarist që është i favorshëm për rritjen e NVM. Kjo arrihet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm të vlerësimit, reformës dhe dialogut me komunitetin afarist. Kjo përfshin një theks të fuqishëm të reformave që nxisin formalizimin e ndërmarrjeve joformale (gjegjësisht regjistrimin e ndërmarrjeve të peregjistruara).
6. Të gjitha shërbimet për zhvillimin e NVM janë udhëzuar, orientuar me kujdes sipas në mbështetje të kërkesës dhe integritimit. Çdo herë kur kjo është e mundur, të gjithë aktorët e përfshirë në sektorin e NVM (publik,

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

privat dhe të komunitetit) dhe vetë sektori i NVM, i përfaqësuar nga organizatat afariste, organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat punojnë së bashku nëpër të siguruar se veprimet e tyre janë të kompletuara dhe të koordinuara.

7. Dialogu i rregullt dhe i strukturuar midis ministrive, sektoreve dhe agjencive të qeverisë qendrore, qeverisë lokale dhe sektorit të NVM është i rëndësishëm thelbësor për rimendimin e ndërhyrjeve efektive për mbështetje dhe për një mjedis më të mirë afarist.
8. Zhvillimi i NVM i kushton vëmendje të veçantë kufizimeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohen gratë dhe të rinjtë që udhëheqin dhe menaxhojnë me ndërmarrjet tyre.
9. Investohet në krijimin dhe menaxhimin e njohurive që lidhen me sektorin e NVM dhe ndërhyrjet në zhvillim.

Në mënyrë plotësuese, "Akti i ndërmarrjeve të Vogla" në Bashkimin Evropian paraqet dhjetë parime kryesore për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla të cilat Qeveria e Maqedonisë i miraton dhe dëshiron t'i zbatojë:

10. Krijimi i një mjedisi në të cilin sipërmarrësit dhe ndërmarrjet familjare mund të persperojnë dhe të shpërblehet sipërmarrësia: Qeveria kujdeset për sipërmarrësit e ardhshëm duke nxitur interesin dhe talentin për sipërmarrësinë, posaçërisht midis personave të rinj dhe grave dhe nëpërmjet thjeshtësimittë kushteve për transferet afariste.
11. Siguri se, sipërmarrësit e ndershëm të cilët kanë qenë subjekt i falimentimit shumë shpejt marrin një mundësi të re: Qeveria promovon qëndrim pozitiv në shoqëri në drejtim të sigurimit të mundësive për një fillim të ri për sipërmarrësit, nëpërmjet lehtësimit dhe përsheptimit të procedurës për parashtrimin e kërkesës së falimentimit jo mashtrues dhe duke siguruar se ndërmarrjet e rifilluara marrin trajtim të barabartë si ndërmarrje sapo të themeluara.
12. Konceptualizimi i rregullave sipas parimit "Mendo njëherë për të voglat": siguri se, të gjitha aktet legislative dhe regulativat e Qeverisë për sektorin e ndërmarrjeve të vogla janë shqyrtuar me kujdes dhe pranuar nga komuniteti afarist para zbatimit të tyre.
13. Administrata shtetërore është në dispozicion për të plotësuar nevojat e NVM.
14. Rifuqizimi i mjeteve nga politikat publike ndaj nevojave të NVM dhe lehtësimi i pjesëmarrjes së NVM në procedurat e prokurimeve publike dhe

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

shfrytëzimi më i mirë i programeve për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

15. Lehtësimit i qasjes në financa për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe zhvillimit të një mjedisi ligjor dhe afarist që mbështet pagesën me kohë në transaksionet tregtare: konkretisht, Qeveria do të lehtësojë promovimin e kapitalit të rrezikuar, mikrokredivë dhe financimit me zëvendësues (financim i kombinuar përmes kredivë dhe pjesëmarrjes në pjesë) dhe do të zhvillojë një mjedis ligjor dhe afarist që mbështet pagesën me kohë në transaksionet tregtare.
16. Ndihma e NVM që më mirë të shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga tregu i vetëm i BE-së: nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të tregut dhe informacionet e vetme, të mundësuarit e përfaqësimit më të mirë të interesave të ndërmarrjeve të vogla në implementimin e standardeve dhe lehtësimin e qasjes në NVM drejtuar lustrimeve dhe markave tregtare.
17. Promovimi i avancimit të shkathtësive në NVM dhe i të gjitha formave të inovacionit: Qeveria inkurajon investimet në hulumtim nga ana e NVM dhe pjesëmarrjeve të tyre në programet **IE**, hulumtimin transnacional, formimin e grupimeve dhe menaxhimin aktiv të pronës intelektuale nga ana e NVM.
18. Aftësimi i NVM për të kthyer sfidat mjedisore në mundësi afariste: Qeveria do të sigurojë më shumë informacione, ekspertizë dhe stimulime financiare për të ndihmuar sektorët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me qëllim që të shfrytëzojnë mundësitë për tregjet e reja "të gjelbërta" dhe rritjen e efikasitetit të energjisë përmes zbatimit të sistemit për menaxhim me mjedisin jetësor në NVM.
19. Inkurajimi dhe mbështetja e NVM në shfrytëzimin e rritjes të tregjeve ndërkombëtare: Qeveria do të lehtësojë sigurimin e mbështetjes së veçantë të tregut dhe aktiviteteve për trajnime afariste dhe informim.

## 5 Shtyllat e strategjisë

Shtyllat e strategjisë janë konceptet themelore të Strategjisë. Ato janë përshtatur në mbështetje me tre objektivat strategjike (të paraqitura në Kapitullin 3).

### Shtylla 1: Mjedis i favorshëm afarist

**Qëllimi strategjik 1: Të krijohet një mjedis i favorshëm afarist i cili inkurajon sipërmarrësinë dhe investimet.**

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Strategjia e NVM do të vazhdojë të mbështesë përmirësimet në mjedisin afarist kombëtar për të siguruar që Republika e Maqedonisë paraqet një mjedis të orientuar drejt biznesit për ndërmarrjet vendase dhe të huaja. Qeveria miratoi qasjen e të ardhurave "Mendo njëherë për të voglat" drejt zhvillimit të politikave dhe programeve.

Me qëllim që të sigurohet realizimi efektiv i politikave dhe masave të parapara në strategji përtë deleguarqartë të drejtat dhe detyrimetefaktorëve të ndryshëm, Qeveria do të miratojë një ligj të ri për NVM me të cilin do të sigurojë bazë ligjore për realizimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe masave. Me ligjin e NVM do të sigurohet klasifikimii vetëm i ndërmarrjeve, me të cilinmë pas do të harmonizohen aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që janë të lidhura me NVM.

Qeveria do të përmirësojë koordinimin dhe integrimin e politikave të saj që i përfshijnë NVM, nëpërmjet krijimit të një organi për monitorimin e realizimit të politikave dhe masave që dalin nga kjo Strategji, në të cilin do të marin pjesë ministritë përkatëse, institucionet shtetërore dhe publike, organizatat afariste, organizatat e punëdhënësve dhe organizatat sindikale. Në të njëjtën kohë, Qeveria do të punojë për të përmirësuar mekanizmin e ofrimit të shërbimeve në zhvillimin e NVM, duke përdorur parimin “one stop shop” apo të gjitha shërbimet në një vend. Ministria e Ekonomisë do të udhëheqë procesin nëpërmjet të të cilit agjencitë për mbështetje të NVM vlerësohen me qëllim të përmirësimit të identifikimit të tyre me grupet e synuara dhe rezultatet e tyre. Edhe pse Qeveria do të vazhdojë të mbështesë AMSRM, institucionet dhe organizatat tjera publike të cilat mbështesin zhvillimin e NVM, ajo do të sigurohetse, ata miratojnë një model për qëndrueshmëri afatgjate. Në mbështetjetë rekomandimevetëEntit shtetëror për revizion (2016), Ministria e Ekonomisë në bashkëpunim me ministritë e tjera, sektoret dhe agjencitë, duke përfshirë edhe Këshillin Kombëtar për ndërmarrësi dhe konkurrueshmëri, do të integrojë politikat kombëtare që lidhen me sipërmarrësinë dhe mbështetjen e zhvillimit të NVM, duke marrë parasysh nevojat dhe informatat kthyesë nga NVM. Kjo do të përfshijë koordinimin dhe integrimin e njësivetë qeverisjes lokale.

Përpjekjet e Qeverisë për thjeshtësimin dhe racionalizimin e të drejtës dhe mjedisit rregullator për NVM do të vazhdojnë duke siguruar që ritmi i reformave për një mjedis më të mirë afarist të ruhet dhe thellohet. Kjo do të përfshijë vlerësimin e ndikimit të ri dhe rregullave ekzistuese ndaj komunitetit afarist. Do të zbatohen reforma të mëtejshme të procedurës së falimentimit,

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

duke përfshirë zvogëlimin e kohës së nevojshme për të përfunduar procedurën e falimentimit e cila aktualisht arrin 1,8 vjet.

Gjithnjë e më shumë vende fillojnë të shohin falimentimin si një përvojë mësimi për sipërmarrësit. Megjithatë, nëse nuk bëhet përkufizimi i qartë ndërmejt sipërmarrësve të ndershëm, sipërmarrësve të pakënaqur, të pandershëm ose mashtrues të cilët kanë qenë subjekt i falimentimit, të parët mund të jenë të stigmatizuar. Prandaj, mungesa e rehabilitimit dhe/aposhlyerjaafatgjate e pagesës së borxheve e vështirësojnë financimin e start-up të reja<sup>6</sup>. OBEZH njeh rëndësinë e ndihmës për sipërmarrësit e ndërmarrjevetë dështuaranë themelimin e ndërmarrjeve të reja dhe të shohin falimentimin si një mjet për të kuptuar se, si të fillohet përsëri. Kjo përfshin përdorimin e fushatave për promovimin e qëndrimeve pozitive drejt ofrimit të një fillimi të ri për sipërmarrësit e pasuksesshëm dhe inkurajimin e sipërmarrësve potencialë që fillojnë përsëri përmes trajnimit dhe fushatave të informimit<sup>7</sup>.

Qeveria do të sjell një sistem paralajmëruar të hershëm për të identifikuar bizneset me vështirësi financiare për t'i ndihmuar në parandalimin e falimentimit, gjegjësisht të zvogëlohet numri i NVMtë cilët falimentojnë. Kjo përfshin krijimin e vetë-kontrollit, qendrat e thirrjeve dhe kurset e trajnimit për identifikimin e ndërmarrjeve me vështirësi financiare<sup>8</sup>. Do të krijohen fushata informative për promovimin e mundësisë së dytëpër sipërmarrësit të cilët më parë kanë dështuar, por kanë fituar përvojë të çmuar në lidhje me themelimin e një ndërmarrjeje.

Në mbështetje me rekomandimet Indeksit të politikave të NVM (OBEZH 2016), Qeveria dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore të përfshira në krijimin aporealizimin e politikave, apo masave të kësaj Strategjie do të fuqizojë konsultimet dhe mekanizmat e tyre për zhvillimin e dialogut me sektorin privat. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së grave afaristenë këto mekanizmadhe në siguriminsendëgjohet zëri i mikro ndërmarrjeve.

Qeveria do të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e të dhënave që grumbullon përNVM. Kjo do të përfshijë përmirësim gjatë monitorimit të rregullt të profilittë NVM (p.sh.numrin e kompanive të themeluara, punësimet, çështjet gjinore dhe vlerat e shtuara), tendencat dhe barrierat. Në mbështetje me rekomandimet e Entit shtetëror për revizion (2016), Ministria e Ekonomisë do të

<sup>6</sup> Komisioni Evropian (2011) *Mundësia e dytë për sipërmarrësit*, KE, Bruksel

<sup>7</sup> OECD (2016), *Indeksi i politikave të NVM-së;Ballkani perëndimor dhe Turqia 2016*, OECD, Paris.

<sup>8</sup> Për indormata plotësuese shih: Komisioni Evropian (2014), *Rekomandim i Komisionit prej 12.3.2014 për Qasjen e re ndaj rënies dhe falimentimit të ndërmarrjeve, COM(2014)*, Komisioni Evropian, Bruksel.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

krijojë një sistem të integruar për të menaxhuar suksesin, të përcaktojë qartë faktorët kyç të suksesit, të masave të veçanta specifike dhe monitorimin e konkurrueshmërisë në NVM, nëpërmjet përcaktimit të përqindjes së pjesëmarrjes në realizimin e treguesve makroekonomikë.

Gjithashtu, do të bëhen përmirësime në mënyrën në të cilën Qeveria monitoron dhe vlerëson ndikimin e programeve dhe shërbimeve të zhvillimit të NVM. Kjo është në përputhshmëri me rekomandimet e politikave të Indeksit të NVM (OBEZH 2016) për zgjerimin e fushëveprimit dhe tërësinë e grumbullimit të dhënave statistikore ndërmjet NVM. Për këtë nevojitet koordinim ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Entitetit shtetëror të statistikës dhe të gjitha institucionet e tjera qeveritare të cilat punojnë në këtë fushë dhe i cili do të përmirësojë shfrytëzimin e informacioneve nga monitorimi dhe informacioni statistikor për vlerësimin e ndikimit të politikave dhe programeve qeveritare.

Përfundimisht, do të sigurohet mbështetje për krijimin e Shoqatës Kombëtare të NVM. Kjo organizatë do të rrisë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e interesave të NVM në krijimin e politikave, zbatimin dhe vlerësimin e programeve qeveritare.

## Shtylla 2: Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM

**Objektivi strategjik 2: T’ju ndihmohet NVM në Maqedoni që të bëhen pjesëmarrës produktivë dhe konkurrues në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.**

Qeveria do të vazhdojë të mbështesë zhvillimin e NVM, duke hequr kufizimet dhe duke inkurajuar rritjen në sektorët e rinj dhe sektorët në zhvillim. **UDP** për zhvillimin e NVM do të përmirësohet. Gjithashtu do të përmirësohen mekanizmat dhe proceset për monitorim, vlerësim dhe mësim lidhur me shërbimet e zhvillimit të NVM. Qeveria do të vazhdojë të promovojë aktivitetet e saj për monitorimin e programeve dhe vlerësimin e ndikimit të shërbimeve të zhvillimit dhe mësimet e nxjerra për të përmirësuar politikën dhe praktikën në zhvillimin e NVM. Kjo do të përfshijë krijimin e mekanizmave për marrjen e informacioneve kthyes nga NVM për të gjitha programet dhe shërbimet e zhvillimit të NVM.

Qeveria do të mbështesë vendosjen dhe përmirësimin e shërbimeve dhe praktikave për zhvillimin e NVM, nëpërmjet mentorimit, trajnimit, mbështetjes financiare, eksperte dhe teknike, shërbimetë akreditimit dhe shërbime të tjera që do të nevojiten për këto ndërmarrje, duke marrë parasysh parimin gjithçka në një vend, me qëllim të qasjes më të lehtë dhe marrjen e informacioneve të kërkuara nga ana e NVM. Gjithashtu, do të sigurohet mbështetje për zhvillimin e

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

grupimeve strategjike dhe zinxhirëve të vlerës. Të gjithë ofruesit e UDRdo të inkurajohen mbidorëzimin e raporteve tek Organi Koordinues për mënyrën se, si ata i përcaktojnë grupet e synuara për programet dhe shërbimet e tyre. Ofruesit e UDRdo të motivohen që përveç llojeve të përgjithshme të trajnimeve, të ofrojnë sesione të veçanta për ndërmarrjet potenciale dhe ndërmarrjet me një shkallë të lartë të rritjes.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përkrahjes së sipërmarrësisë së grave. Kjo është në mbështetje me rekomandimet e fundit të BE-së, në raport të zhvillimit të NVM<sup>9</sup>. Do të bëhet një strategji e veçantë për sipërmarrësinë e grave në të cilën ofruesit e UDRdo të mbështeten në përpjekjet për përgatitjen e mjeteve dhe metodave të veçanta në këtë fushë.

Qeveria gjithashtu do të mbështesë një sektor produktiv dhe konkurrueshëm të NVM duke përmirësuar qasjen në NVM në shërbimet financiare. Megjithëse, është arritur përparim i dukshëm në këtë fushë, nevojiten përmirësime të mëtejshme. Reformat e mëtejshme në këtë fushë do të përfshijnë krijimin e një regjistri online të pasurisë së luajtshme i cili mund të përdoret si kolateral për huatë bankare, krijimin e një portali ku NVM mund të marrin të gjitha informatat për të gjitha format e financimit, programeve dhe fondet për mbështetjen e NVM (vendase dhe të huaja).

Politika Industriale Kombëtare (2009-2020) bën thirrje për vendosjen e instrumenteve të reja financiare për zhvillimin e NVM. Në mbështetje me rekomandimet e Indeksit të Politikave të NVM (OBEZH 2016), do të zbatohet program për promovim përdorimit të faktoringut. Përveç kësaj, do të rishikohet skema e garantuesit të kredisë, duke thjeshtësuar procedurat e saja, në bashkëpunim të ngushtë me bankat private dhe me reformimin e përgjithshëm të dizajnit, strukturës dhe kushteve të kësaj skeme.

Një fushatë edukative dhe informative për arsimim financiar do të vendoset në sistemin për arsim të mesëm, në institucionet për arsimim të përgjithshëm dhe profesional teknik dhe do të përfshihet në pakon e shërbimeve të trajnimit që sigurohen nga agjencitë për zhvillimin e NVM.

Qeveria krijonjë kornizë strategjike dhe institucionale për promovimin e eksporteve me qëllim të përmirësimit të ndërkombëtarizimit të sektorit të

---

<sup>9</sup> Komisioni Evropian (2016) *Republika e Maqedonisë, Raport për 2016*; Lajmërim nga Komisioni deri te Parlamenti Evropian, Këshilli, Komiteti socio – ekonomik i rajoneve, 2016 Lajmërim për politikën për zgjerim të BE-së, Dokument pune e shërbimit profesional të Komisionit, 9 nëntor, Bruksel.



*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

NVM. Për të dhënë siguri se, sektori i NVM orientohet drejt eksportit dhe menaxhohet sipas mundësive të reja në BE dhe në botë, Qeveria do të intensifikojë mbështetjen e saj në këtë fushë. Do të caktohet një vlerësim kombëtar i mundësive, pengesave dhe kapaciteteve të NVM për hyrje në tregjet e reja ndërkombëtare. Rezultatet nga ky vlerësim do të sigurojnë informacione të drejtpërdrejta mbi rishikimin e strategjisë kombëtare të eksportit, e cila do të integrohet në zhvillimin e NVM. Qeveria do të sigurojë më shumë mjete për agjencinë e cila do të promovojë eksportin dhe do të përmirësojë monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve të promovimit të eksporteve. Kjo do të përfshijë integrim dhe koordinim më të madh në AMSRM dhe organizatat tjera relevante. Do të krijohet një portal në të cilin të gjitha NVM do të marrin informacione dhe të dhëna mbi kushtet, mundësitë dhe kufizimet në tregjet e huaja, të cilat do t’ua lehtësojnë qasjen në tregjet e huaja.

Qeveria do të mbështesë pjesëmarrjen e NVM në sektorët strategjik industrial. Do të bëhen përpjekje më të mëdha për identifikimin e zinxhirëve kryesorë ndërkombëtarë të vlerës në të cilët NVM maqedonase kanë kapacitet në pjesëmarrje të suksesshme dhe do të zhvillohen programe dhe shërbime për t’i ndihmuar këto kompani të hyjnë në këto tregje. Kjo realizohet në mbështetjetë Politikave Industriale Kombëtare (2009-2020), qëllimi kryesor i së cilës është përmirësimi i bashkëpunimit në grupime dhe rrjete industriale. Ky aktivitet do të zbatohet në partneritet me Rrjetin evropian të ndërmarrjeve. Siç nënvizohet në Politikën Industriale, Republika e Maqedonisë deri në vitin 2020, do të zhvillojë lidhje dinamike të industrive të qëndrueshme dhe autentike në fushat e mëposhtme: verë organike dhe ushqim, eko-çelik, ndërtim ekologjik, TIK, pjesë të specializuara elektronike, prodhim të energjisë së ripërtëritshme, industri kreative, pajisje mjekësore dhe shërbime, turizëm autentik dhe industritë tjera.

Për avancimin e reformave të saj në sektorin TIK, Qeveria do të mbështesë zhvillimin e NVM në këtë sektor, duke promovuar shfrytëzimin e TIK nga ana e NVM si një strategji për nxitjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë në rritje.

Qeveria do të mbështesë zhvillimin e NVM në kuadër të ekonomisë së gjelbër. Kjo do të përfshijë reforma të politikave kombëtare si dhe dizajnim të instrumenteve dhe shërbimeve mbështetëse për sigurimin e stimulimit dhe mbështetjessë "NVM të gjelbra" në kuadër të tregjeve të cilat janë të lidhur me mjedisin jetësor si dhe për mbështetjen e miratimit të praktikave të pranuar afariste dhe ekologjike. Kjo gjithashtu, është në mbështetje me politikat kombëtare industriale, ku një nga qëllimet kryesore është mbështetja e

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

prodhimeve ekologjike të pranuar dhe shërbimeve. Kjo do të ndërlidhet edhe në programin përbashkët të Qeverisë dhe Bankës Botërore për të mbështetur industrinë konkurruese dhe inovacionet.

Përfundimisht, Qeveria do të mbështesë krijimin e një Portalionline për NVM, i cili do të sigurojë një seri informacione të dobishme për sektorin e NVM, duke përfshirë informacionin nga politikat, programet, trendet dhe shërbimet mbështetëse. Portali do të lidhet me sistemet tjera njësportelësh të Qeverisë dhe iniciativat tjera për e – vllada. Kjo përfshin krijimin e "sistemit gjithëpërfshirës njësportelësh" i cili do të funksionojë si një rrjet reciprociteti i sistemit njësportelësh, për dhënie të licencave dhe lejeve afariste që aktualisht funksionojnë në vend. Siç nënvizohet në Strategjinë Kombëtare të konkurrueshmërisë me Plan Veprimi (2016-2020), kjo do të përfshijë zhvillimin e bazës të të dhënave në interneti cili mund të kërkohet dhe i cili do të mund tju ndihmojë shfrytëzuesve të përcaktojnë se cilat janë licencat, lejet dhe miratimet e nevojshme për themelimin e një ndërmarrje; do të mundësojë shkarkimin dhe dorëzimin e formularëve të nevojshëm, duke përfshirë zhvillimin e një linku dinamik me institucionet, për të siguruar që baza e të dhënave të azhurnohet vazhdimisht, çdoherë që ndryshohen kërkesat e lidhura me licencat, lejet dhe miratimet.

Shtylla 3: Ekosistem dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacioneve

**Objektivi strategjik 3: Konkurrueshmëria ekonomike e Maqedonisë inkurajohet gjithnjë e më shumë nga sektori ndërmarrës dhe inovativ i NVM.**

Strategjia e NVM do të krijojë një ekosistem dinamik të sipërmarrësisë dhe inovacionit në të cilin ndërmarrjet e reja, inovative në themelimin e tyre inkurajohen dhe mbështeten. Kjo do të fuqizojë lidhjet midis industrisë, arsimit dhe komunitetit kërkimor – shkencor. Ndërmarrjet maqedonase rrallë herë mbajnë lidhje të ngushta me institucionet arsimore, shkencore dhe qendrat hulumtuese. Krijimi, fuqizimi dhe mbajtja e këtyre lidhjeve do të inkurajojë ndërkombëtarizimin e aktiviteteve hulumtuese dhe do të ndihmojë në promovimin e partneriteteve me institutet dhe ndërmarrjet evropiane hulumtuese.

Qeveria ka njohur rëndësinë e zhvillimit të kapitalit njerëzor nëpërmjet përgatitjes të të rinjve për sfidat e sipërmarrësisë. Strategjia Kombëtare për mësim të sipërmarrësisë dhe iniciativat e Rrjetit kombëtar të mësimdhënësve

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

përsipërmarrësi përcaktojnë udhëzime të qarta në këtë drejtim. Në fazën e ardhshme të këtyre përpjekjeve, Qeveria do të integrojë trajnimin e mësuesve dhe nxënësve për të siguruar që ajo të jetë në dispozicion të të gjitha niveleve në sistemin arsimor. Kjo do të përfshijë krijimin e partneriteteve të reja midis Qeverisë, industrisë dhe arsimit.

Do të përmirësojë koordinimin ndërmjet ofruesve të shërbimeve publike, private, joqeveritare dhe ndërkombëtare. Trajnimi për NVM-të dhe gratë sipërmarrëse do të përmirësohet, programet, shërbimet e arsimit dhe trajnimin profesional do të harmonizohen me nevojat e punëdhënësve në përputhje me strategjinë e miratuar më parë për arsim dhe trajnim profesional. Sistemet për arsim profesional dhe të lartë në Maqedoni do të forcohen për të përmbushur sfidat e reja për komunitetin afarist dhe kërkimoro - shkencor. Më tutje, sektori teknik dhe shkencor do të marrë resurse shtesë për mbështetjen e zhvillimit të inxhinierëve dhe shkencëtarëve gjatë gjithë karrierës. Qeveria gjithashtu do të stimulojë dhe lehtësojë bashkëpunimin e përmirësuar mes bashkësisë akademike dhe sektorit privat. Kjo do të përfshijë përdorimin e instrumenteve financiare, siç janë kuponët për inovacion, si dhe sigurim i drejtëpërdrejtë financiar, mbështetje për IR dhe inovacion.

Qeveria do të përmirësojë infrastrukturën dhe shërbimet për mbështetje institucionale të cilat janë të nevojshme për të promovuar inovacionin nëpërmjet zhvillimit të aftësive të lehta dhe aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të NVM-ve dhe iniciativave fillestare, si dhe mbështetjen përmes rrjeteve, duke bashkuar bashkësinë akademike, sektorin privat dhe faktorët e tjerë. Kjo do të përfshijë aktivitete të cilat janë të dedikuara për përmirësimin e aksesit në financa për komercializimin e inovacioneve të reja, duke përfshirë edhe kapitalin sipërmarrës. Qeveria themeloi një Fond për inovacion dhe zhvillim teknologjik. Zgjerimi i këtyre përpjekjeve do të përfshijë hulumtimin mbi fondet ndërkombëtare sipërmarrëse dhe investuese dhe një rrjet më të fortë të engjujve të biznesit për të siguruar financim privat për ndërmarrjet me një shkallë të lartë rritjeje.

Qeveria do të lehtësojë themelimin e më shumë parqeve shkencore, teknologjike dhe inkubatorëve të inovacionit për të krijuar një ekosistem më dinamik për sipërmarrësinë dhe inovacionet, si dhe do të mbështesë kapacitetet ekzistuese për të siguruar qëndrueshmërinë e tyre. Gjithashtu do të shqyrtojë mundësitë e krijimit të së paku dy parqeve teknologjike të lidhura me universitetet dhe institucionet teknike, së bashku me së paku pesë inkubatorë ose përsheptues

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

për inovacion dhe qendrat start – up në nivel komunal ose rajonal. Në rastin e parë, Qeveria do të kryejë një studim fizibiliteti mbi themelimin e parqeve shkencorë - teknologjike, e cila do të përfshijë mundësi për mënyra të ndryshme të punës.

## 6 Programe

Shtylla 1: Mjedis i favorshëm afarist

Programi 1.1: Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit

Qeveria do të përmirësojë koordinimin dhe integrimin e politikave të saja që përfshijnë NVM, njëkohësisht duke përmirësuar mekanizmin për sigurimin e shërbimeve të zhvillimit të NVM.

**Rezultatet:** Përmirësimi i koordinimit të Qeverisë dhe integrimi i politikave brenda sektorit të NVM dhe një mekanizëm më i mirë për ofrimin e shërbimeve të zhvillimit të NVM.

**Aktivitete kryesore:**

1. Koordinimi i politikave dhe programeve për mbështetjen e NVM nëpërmjet bashkëpunimit me të gjitha ministritë, sektorët dhe agjencitë si dhe strukturat rajonale dhe lokale.
2. Vazhdimi i mbështetjes për AMSRM, Fondineinovacioneve dhe zhvillim teknologjik, institucionet dhe organizatat tjera publike që mbështesin zhvillimin e NVM dhe sigurojnë harmonizimin efektiv dhe përkufizimin e grupeve specifike të synuara në lidhje me definimin e vetëm për NVM.
3. Vlerësimi i institucioneve për mbështetjen e NVM-ve dhe shërbimeve të tyre.
4. Punë me institucionet të cilat mbështesin zhvillimin e NVM për të shqyrtuar dhe zbatuar një model përqëndrueshmëri afatgjatë.
5. Krijimi i një Trupi koordinues që do të kujdeset për zbatimin e politikave dhe masave të kësaj Strategjie dhe për koordinimin e donatorëve të masave për mbështetjen e NVM.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

6. Hulumtimi i mundësive për politikat dhe programete shqyrtuara për inkurajimine përgjegjesisë sociale të korporatës.

<b>Institucioni drejtues</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>Organi kordinues</b>	Themeluar nga të gjitha ministritë përkatëse, <b>КПБPM, ЗКПБPM</b> , institucione për mbështetje të NVM
<b>Grupet e synuara:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Të gjitha ministritë qeveritare, sektoret dhe agjencitë</li><li>• Autoritete lokale dhe</li><li>• Agjencitë për zhvillim të NVM (AMSRM dhe të tjera)</li></ul>

#### Programi 1.2: Thjeshtësimi i mjedisit logjor dhe rregullator

Përpjekjet e Qeverisë për thjeshtësimin dhe ristrukturimin e mjedisit ligjor dhe rregullator për NVM do të vazhdojnë duke siguruar që ritmi i reformave për një mjedis më të mirë afarist të mirëmbahet dhe thellohet. Kjo do të përfshijë reforma të mëtejshme të procedurës së falimentimit, përfshirë edhe zvogëlimin e kohës së nevojshme për përfundimin e procedurës së falimentimit.

<b>Rezultat:</b>	Kuadri ligjor dhe rregullator për NVM është "i orientuar drejt biznesit", me një numër të reduktuar të hapave dhe kohës së nevojshme për të arritur pajtueshmërinë me BE-në.
<b>Aktivitetet kryesore:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Krijimi i ligjit për NVM dhe vazhdimi i reformave për harmonizimin e legjislacionit kombëtar në lidhje me NVM me legjislacionin e BE-së;</li><li>2. Rritja e shfrytëzimit të VNR në vlerësimin ex-post, përfshirë testin NVM<sup>10</sup></li><li>3. Vazhdimi i reformave të procedurës së falimentimit, duke përfshirë zvogëlimin e kohës së duhur për përfundimin e procedurës së falimentimit (aktualisht është 1,8 vjet);</li><li>4. Vendosja e sistemit për paralajmërimin hershëm mbi identifikimin e kompanive me vështirësi financiare për të</li></ol>

<sup>10</sup> Siç është e nënvizuar në raportin e Grupit të ekspertëve të KE-së prej vitit 2009, *Së pari mendo për të voglat; Duke marrë parasysh interesat e NVM –ve në hartimin e politikave, mars, Drejtori e përgjithshme e KE-së për ndërmarrësi dhe industri*

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

ndihmuar në parandalimin e falimentimit (p.sh. futja e instrumenteve të vetë kontrollit, qendrat e thirrjeve dhe kurseve për trajnim);

5. Dizajnimi dhe zbatimi i fushatave informuese për të promovuar një mundësi të dytë për sipërmarrësit që kanë dështuar më parë, por kanë fituar përvojë të vlefshme në raport të krijimit të një ndërmarrje;
6. Dizajnimi dhe zbatimi i fushatës për të informuar dhe rritur vetëdijen për përfitimet nga formalizimi (gjegjësishtinkurajim i bizneseve për regjistrimin dhe marrjen e të gjitha licencave të nevojshme);
7. Shqyrtimii proceseve të fshirjes së ndërmarrjeve nga regjistri.
8. Zvogëlimi i shpenzimeve për start – up ndërmarrjet fillestare nëpërmjet përpunimit të analizës në të cilën do të definohen rekomandimet dhe masat specifike

**Institucioni drejtues**

Ministria e Ekonomisë, Regjistri qendror dhe **KIPBPM**

**Grupet e synuara:**

Të gjitha ministritë e qeverisë, sektoret dhe agjencitë, duke përfshirë Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale

Autoritetet rajonale dhe lokale

Institucionet për zhvillim të NVM (AAMSRM, Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik, etj)

**Programi 1.3: Fuqizimi dhe institucionalizimi i dialogut social**

Qeveria do të fuqizojë konsultimet dhe mekanizmat e saja për udhëheqjen e dialogut me sektorin privat. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përfshirjes së grave afariste në këto mekanizma, si dhe sigurimin e përfaqësimit të mikro ndërmarrjeve.

**Rezultat:**

Është krijuar një mekanizëm për dialog të rregullt dhe të strukturuar social për sigurimin e informacioneve mbi krijimin dhe reformimin e politikave publike, ligjeve dhe rregulloreve në sektorin e NVM.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Lidhshmëria me përfaqësuesit e komunitetit të NVM për identifikimin e nevojave, interesave dhe potencialin për

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

dialog të zgjeruar social;

2. Përgatitja e një studimi të fizibilitetit për të shqyrtuar rolin, strukturën, anëtarësimin dhe funksionalitetin e mekanizmit të nivelit të lartë të dialogut social, duke siguruar një përfaqësim të fuqishëm të grave;
3. Konsultime me sektorin privat dhe komunitetin e NVM për mekanizmin e duhur të dialogut social;
4. Reformat dhe ndjekja e mekanizmit ekzistues të dialogut social.

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë

**Organi kordinues** Themeluar nga të gjitha ministritë përkatëse, **KPVRM**, **3KPIBPM**, institucionet për mbështetjen e NVM dhe Këshillinkombëtar për mbështetjen e ndërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë

**Grupet e synuara:**

- Të gjitha ministritë qeveritare, sektoret dhe agjencitë
- Këshilli ekonomik - social
- Agjencitë për zhvillim të NVM (AMSRM dhe etj.)
- Organizatat përfaqësuese afariste dhe organizatat e punëdhënësve

#### Programi 1.4: Përmirësimi i koordinimit në grumbullimin e të dhënave për NVM për shkak të përmirësimit të politikave për mbështetjen e NVM

Qeveria nëpërmjet Trupit koordinues do të përmirësojë cilësinë dhe sasinë e të dhënave që grumbullohen për sektorin e NVM. Do të përmirësojë mënyrën në të cilën këta informacione grumbullohen dhe shpërndahen deri, dhe shfrytëzohen prej të gjitha anëve relevante. Qeveria do të krijojë një sistem të integruar për menaxhimin e performancës mbi përcaktimin e qartë të faktorëve kryesorë të suksesit veçmas të masave specifike dhe monitorimit të konkurrueshmërisë së NVM nëpërmjet përcaktimit të përqindjes pjesëmarrëse në realizimin e treguesve makroekonomikë.

**Rezultatet:** Të dhënat sasiore dhe cilësore relevante të ndara sipas gjinisë, për sektorin e NVM dhe trendet e tyre janë përgatitur dhe bërë publike, së bashku me rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

të rregullt.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Përpunimii studimit mbi të dhënat aktuale statistikore dhe analitike për sektorin e NVM dhe mënyrat se, si kjo mund të përmirësohet;
2. Përmirësimi i cilësisë dhe sasisë të të dhënave në sektorin e NVM dhe krijimin e sistemit të integruar për menaxhim me suksesin mbi definimin e qartë të faktorëve kyç të suksesit, të masave të veçanta dhe për monitorimin e konkurrueshmërisë së NVM, nëpërmjet përcaktimit të përqindjes pjesëmarrëse në treguesit makroekonomik (p.sh., numri i kompanive të themeluara, punësimi, pjesëmarrja në vlerën e shtuar), trendet dhe barrierat - duke përfshirë informacionet e veçantalidhur me trendet e hapjes së vendeve të punës dhe dinamikën në sektorin e NVM;
3. Përmirësimi i përdorimit të informacionit të monitorimit dhe informacionit statistikor për vlerësimin e ndikimeve politike dhe programeve qeveritare.
4. Zbatimi i praktikave të krijuara politike të reja, programeve dhe masave (gjegjësisht plane vjetore) në bazë të rezultateve nga analizat e bëra më parë për ndikime politike të deritanishme në zhvillimin e NVM

**Institucioni drejtues**

Ministria e Ekonomisë

**Grupet e synuara:**

- Enti shtetëror për statistikë
- Agjencitë për zhvillimin e NVM (AMSRM dhe etj.)
- Organizatat përfaqësuese afarist dhe organizatat e punëdhënësve

**Programi 1.5: Përmirësimi i përfaqësuesve të NVM – Shoqata kombëtare e NVM**

Qeveria do të kryejë vlerësim dhe sipas nevojës do të promovojë themelimin e Shoqatës kombëtare të NVM për përfaqësimin e interesave të NVM në krijimin e politikave, zbatimin dhe vlerësimin e programeve të Qeverisë. Shoqata do të ndërlihet me punën e Odës ekonomike përmes fokusimit të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla. Shoqata do të pasqyrojë rolin e Këshillit kombëtar të



*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

ndërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë dhe do të sigurojë se, sektori i NVM bashkëpunon me Qeverinë.

**Rezultatet:** Ndërmarrjet mikro dhe të vogla janë të përfaqësuara në proceset për krijimin e politikave dhe shqyrtimin e programeve nëpërmjet anëtarësimit të tyre në Shoqatën kombëtare të NVM.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Vlerësimi i nevojës për qëllimin potencial të Shoqatës kombëtare të NVM;
2. Konsultimet me sektorin e NVM dhe strukturat ekzistuese përfaqësuese për rezultatet e studimit të nënvizuar dhe hapat e ardhshëm.

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë

**Grupet e synuara:**

- Agjencitë për zhvillimin e NVM (AMSRM etj.)
- Organizatat përfaqësuese afarist dhe organizatat e punëdhënësve

Shtylla 2: Sektori produktiv dhe konkurrues në NVM

#### Programi 2.1: Përmirësimi i shërbimeve në zhvillimin afarist

Qeveria do të mbështesë efikasitetin dhe ndikimin e **YDP** në sektorin e NVM në bazë të zbatimit të vlerësimit të nevojave. Do të përmirësohen mekanizmat dhe proceset për monitorim, vlerësim dhe të mësuarit për shërbimet e zhvillimit të NVM dhe do të sigurohet mbështetje për përmirësimin e shërbimeve dhe praktikave për zhvillimin e NVM, nëpërmjet trajnimit, mbështetjes financiare, ekspertizës dhe mbështetjes teknike, shërbime për akreditim dhe shërbime të tjera të cilat do t'i nevojiten NVM, duke marrë parasysh parimin gjithçka në një vend, me qëllim të qasjes dhe marrjes më të lehtë të informacionit nga ana e NVM. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përkrahjes së sipërmarrësisë së grave. Në këtë drejtim përfshihen edhe aktivitetet dhe masat e parashikuara në planin e veprimit të strategjisë së konkurrueshmërisë.

Përveç aktivitetëve të nënvizuara, AMSRM do të krijojë një shërbim për mbështetjen e mentorimit në mbështetjet e Agjencisë japoneze për bashkëpunim ndërkombëtar.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

**Rezultatet:** UDR janë më të rëndësishme në zhvillimin e nevojave dhe aftësive të NVM dhe sigurohen në një mënyrë ekonomike, të koordinuar dhe fokusuar ndaj klientëve.

Ndikimi i UDR reduktohet në mënyrë të rregullt dhe i nënshtrohet raporteve publike.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Monitorimi dhe vlerësimi i programeve dhe shërbimeve të NVM;
2. Vendosja e një kuadri për vlerësimin dhe matjen e suksesit për zhvillimin e NVM;
3. Identifikimi dhe promovimi i rregullt i praktikave të mira në zhvillimin e NVM dhe krijimi i mundësive për mësim ndërmjet ofruesve të shërbimeve të NVM;
4. Hulumtimi i realizueshmërisë dhe fushëveprimit të sistemit kombëtar të akreditimit të UDR;
5. Vendosja e mekanizmave për marrjen e informacioneve kthyes nga klientët për të gjithë klientët e UDR;
6. Sjellja e një procesi vjetor nëpërmjet të cilit të gjithë ofruesit e UDR publikisht raportojnë mbi grupet, shërbimet dhe rezultatet e tyre;
7. Përpunimi i studimit për nevojat, mundësitë dhe pengesat me të cilat ballafaqohen gratë afariste dhe siguriase, konstatimet e këtij studimi përdoren për përmirësimin e furnizimit të UDR;
8. Hapja e një portali për NVM që do të ofrojë informata të dobishme për NVM anëmbanë vendit. Portali do të lidhet me sistemet e qeverisë një sportelëshe duke përfshirë edhe sistemin një sportelësh për leje dhe licenca afariste, si dhe për iniciativat e tjera përe - vllada. Portali do të përfshijë bazë të të dhënave që mund të kërkohet me ligjet, rregulloret dhe lejet përkatëse. Kjo do të sigurojë platformë të vlefshme për komunikimet online ndërmjet qeverisë dhe komunitetit të NVM. Sikurse është nënvizuar më lartë, Ministria e shoqërisë informatike dhe e administratës do ta udhëheqë këtë aktivitet në mbështetje me dispozitat nga Strategjia kombëtare

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

përkonkurrueshmëri.

9. Përmirësimi i qasjes në programet e BE-së për promovimin e NVM dhe lidhjet me programet rajonale të BE-së (p.sh. Programi për konkurrueshmërinë e NVM- COSME, Programi për financim, hulumtim dhe inovacion - Horizon 2020, Programi i punësimit dhe inovacionit social - komponenti PROGRES, Erasmus dhe Jetë +).
10. Zhvillimi i një programi për trajnim për përmirësimin e shkathtësive, përmirësimin e menaxhimit afarist për ndërmarrjet të cilat janë në pronësi dhe udhëheqen nga personat e rinj.

<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria e Ekonomisë, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Dministratës dhe <b>ЗКПБМ</b>
<b>Grupet e synuara:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Agjencitë për zhvillimin e NVM (AMSRM etj.)</li><li>• Organizatat përfaqësuesve afarist dhe organizatat e punëdhënësve</li></ul>

#### Programi 2.2: Përmirësimi i qasjes në financa

Qeveria do të prezantojë instrumente të reja financiare për zhvillimin e NVM, në mbështetje me rekomandimet e BE-së nga viti 2016 lidhur me zhvillimin e NVM në Maqedoni<sup>11</sup>. Këtu përfshihet krijimi i regjistrimit online të pasurisë së luajtshme i cili mund të përdoret si kolateral për huatë bankare, së bashku me rivitalizimin e skemës së kredisë dhe garancisë. Gjatë gjithë afatit kohor për zbatimin e Strategjisë, Qeveria do të shqyrtojë mundësitë reja për reformat e politikës së financimit të NVM dhe zhvillimin e programeve. Kjo do të përfshijë përdorimin e garancive qeveritare për kredi, përfshirë garancitë e eksportit për NVM kreditë drejtpërdrejta të NVM, kreditë e subvencionuara, kapitali sipërmarrës, financimime kapital aksionari dhe rritja e angazhimit dhe përfaqësimit përpara sektorit bankar komercial<sup>12</sup>. Qeveria gjithashtu do të shqyrtojë mundësitë për të inkurajuar investimet në NVM në diasporën maqedonase. Do të zbatohen fushata informimi dhe edukimi për kulturën financiare.

<sup>11</sup> Komisioni Evropian (2016) *Republika e Maqedonisë, Raporti për v.2016*; Lajmërim nga Komisioni deri te Parlamenti evropian, Këshilli, Советот, Komiteti ekonomik – social dhe Komiteti i rajoneve, 2016 Lajmërim i politikave për zgjerim të BE-së, Dokument pune i shërbimit profesional të Komisionit, 9 nëntor, Bruksel.

<sup>12</sup> Për shembull, shih: OECD (2015) *Financim i NVM-ve dhe sipërmarrës 2015: Vlerësime të OECD*, OECD Publishing, Paris

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

**Rezultatet:** NVM kanë qasje më të madhe në një gamë më të gjerë të produkteve dhe shërbimeve financiare për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe rritjen e tyre.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Krijimi i një regjistri online të pasurive të luajtshme, i cili mund të përdoret si kolateral për huatë bankare;
2. Vendosja e programit për promovimin e shfrytëzimit të faktorizimit për fuqizimin e sigurisë ligjore dhe transparente.
3. Rigjallërimi i skemës së kredisë dhe skemës së parave ekzistuese brenda **МБПР**, duke thjeshtësuar procedurat e saj, në bashkëpunim të ngushtë me bankat private dhe duke përmirësuar dizajnin, strukturën dhe kushtet e kësaj skeme.
4. Krijimi i një fushate informative dhe edukative për njohuritë financiare dhe vendosja e saj në sistemin e arsimit të mesëm, institucionet e arsimit të përgjithshëm, profesional dhe teknik si dhe në pakon e shërbimeve të trajnimit të ofruara nga agjencitë për zhvillimin e NVM.
5. Thjeshtësimi i procedurave për themelimin dhe punën e institucioneve financiare që ofrojnë instrumente alternative financiare (factoring, lizing, fondetë kapitalit, etj.)

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë, **КЗПБPM**, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë

**Grupet e synuara:**

- Ministria e Financave
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- **МБПР**
- Agjencia e zhvillimit të NVM (AMSRM etj.)
- Bankat komerciale
- Byroja për Zhvillimin e Arsimit
- Regjistri Qendror
- **КПБPM** dhe **ЗКПБPM**

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

### Programi 2.3: Lehtësimi i ndërkombëtarizimit

Do të sigurohet më shumë mbështetje për të përmirësuar ndërkombëtarizimin e sektorit të NVM me qëllim që të vërtetohet se, sektori i NVM është i orientuar nga eksporti dhe udhëheqet sipas mundësive të reja në BE dhe në botë.

<b>Rezultatet:</b>	Rritja e pjesëmarrjes së NVM në tregjet ndërkombëtare.
<b>Aktivitetet kryesore:</b>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Krijohen lidhje më të fuqishme në politikat dhe programet e zhvillimit të NVM dhe mbështetje të Qeverisë për promovimin e eksporteve;</li><li>2. Parashikimi i një vlerësimi kombëtar i mundësive, përkufizimeve dhe kapaciteteve të NVM për hyrje në tregjet ndërkombëtare në rritje të shpejtë dhe sigurisë, rezultatet përdoren për të rishikuar strategjinë kombëtare të eksportit;</li><li>3. Rritja e mbështetjes për agjencinë e promovimit të eksporteve dhe identifikimi i koordinimit dhe aktiviteteve të përbashkëta të zbatimit ndërmjet kësaj agjencie dhe AMSRM në zbatimin e aktiviteteve për promovimin e eksporteve - duke formuluar një program për nxitjen e eksporteve të NVM;</li><li>4. Përmirësimi i monitorimit dhe vlerësimit të shërbimeve për promovimin e eksportit me publikimin e raportit vjetor mbi pjesëmarrjen e NVM në tregjet e eksportit.</li></ol>
<b>Institucioni drejtues</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>Grupet e synuara:</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksporteve</li><li>• Agjencia e zhvillimit të NVM (AMSRM etj.)</li><li>• Bankat komerciale</li><li>• <b>КПВРМ</b> dhe <b>ЗКПВРМ</b></li></ul>

### Programi 2.4: Mbështetje e zhvillimit të zinxhirit të vlerave

Qeveria do të mbështesë pjesëmarrjen e NVM në zinxhirët e vlerave strategjike. Do të sigurohet mbështetje e madhe për reformat e sektorit të TIK - Qeveria do të mbështesë zhvillimin e NVM në këtë sektor, duke promovuar përdorimin e

*"Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse"*

TIK nga ana e NVM si një strategji për nxitjen e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë në rritje. Mbështetje do t'i jepet gjithashtu zhvillimit të NVM në ekonominë e gjelbër dhe zhvillimin e "NVM të gjelbra".

**Rezultatet:** Rritja e pjesëmarrjes së NVM në sektorët strategjik, industrialë që janë të orientuar drejt rritjes.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Identifikimi i zinxhirëve kryesorë ndërkombëtarë të vlerës në të cilët NVM maqedonase kanë kapacitet për pjesëmarrje dhe zhvillim të suksesshëm të programeve dhe shërbimeve që do t'i ndihmojnë këtyre kompanive për të hyrë në këto tregje;
2. Mundësimi i marrëveshjeve më të fuqishme të partneritetit midis AMSRM, Agjencisë për investime të huaja dhe promovimit të eksportit dhe rrjetitevropian të ndërmarrjeve;
3. Mbështetja e zhvillimit të NVM në sektorin e TIK nëpërmjet instrumenteve të specializuara të **УДР** dhe shërbimeve financiare;
4. Mbështetje në zhvillimin e NVM në ekonominë e gjelbër duke reformuar politikat kombëtare dhe duke hartuar instrumente dhe shërbime mbështetëse për të ofruar stimulim dhe mbështetje për "NVM e gjelbërta" brenda tregjeve të cilat lidhen me mjedisin jetësor.

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë

**Grupet e synuara:**

- Rrjeti evropian i ndërmarrjeve
- Agjencia për investime të huaja dhe promovim të eksporteve
- Agjencia e zhvillimit të NVM (AMSRM etj.)
- Bankat komerciale
- Ministria e Transportit dhe Lidhjes
- Ministria e Shoqërisë së Imformatikës dhe Administratës
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

### Shtylla 3: Sistemi dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacionit

#### Programi 3.1: Zgjerimi i sipërmarrësisë në arsim dhe trajnim

Duke njohur rëndësinë e zhvillimit të kapitalit njerëzor në Maqedoni përmes përgatitjes të personave të rinj për sfidat e ndërmarrësisë (duke përfshirë sipërmarrësinë sociale), Qeveria do të zgjerojë arsimimin e ndërmarrësisë. Ajo do të integrojë arsimimin për sipërmarrësi nëpërmjet zgjerimit të trajnimit të mësuesve dhe nxënësve për të siguruar se, është në dispozicion të të gjitha niveleve të sistemit arsimor. Përforcimi i sistemeve për arsimim profesional dhe të lartë për të përballur sfidat e reja për komunitetin afarist dhe hulumtues - shkencor. Për më tepër, sektori teknik dhe shkencor do të marrin resurse plotësuese për të mbështetur zhvillim të inxhinierëve dhe shkencëtarëve gjatë gjithë karrierës.

**Rezultatet:** Aftësitë sipërmarrëse janë të integruara në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Zgjerimi i programit të edukimit për sipërmarrësi në shkollat për arsim të mesëm dhe në sistemin për arsimin e mesëm profesional dhe trajnim, përfshirë trajnimin për sipërmarrësi sociale;
2. Vendosja e mbështetjes së re dhe të vazhdueshme për partneritetet ekzistues dhe iniciativat ndërmjet institucioneve qeveritare, arsimore, kërkimore dhe industria;
3. Përmirësimi i trajnimit të ndërmarrësisë për gratë sipërmarrëse nëpërmjet zhvillimit të modulit për trajnim që mund të shfrytëzohet në shumë kontekste të ndryshme të trajnimit;
4. Përforcimi i sistemeve të arsimit profesional dhe të lartë për të përballur sfidat e reja për komunitetin afarist dhe hulumtues - shkencor

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë

**Grupet e synuara:**

- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- Ministria e Kulturës
- Rrjeti kombëtar i edukatorëve të ndërmarrësisë
- Agjencia e zhvillimit të NVM (AMSRM etj.)

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

- Universitetet
- Qendra për arsim të mesëm profesional
- Organizata afariste dhe organizata të punëdhënësve
- **KПBPM**dhe**3KПBPM**

### Programi 3.2: Përmirësimi i shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në zhvillimin e NVM

Në mënyrë plotësuese do të zhvillohen shërbimet infrastrukturore dhe mbështetëse institucionale, të nevojshme për promovimin e inovacioneve të NVM. Kjo do të përfshijë zhvillimin e rrjeteve që lidhin bashkësinë akademike me sektorin privat dhe faktorët e tjerë, së bashku me përmirësimet në Fondin për inovacion dhe zhvillim teknologjik.

**Rezultatet:** Rritja e NVM është nxitur nga rritja e transferimit të teknologjisë dhe inovacionit.

**Aktivitetet kryesore:**

1. Lehtësimi i rrjetëzimit të komunitetit akademik, sektorit privat dhe faktorëve të tjerë, duke përfshirë edhe faktorët financiarë;
2. Mbështetja e Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik për rritjen e vëllimit të shfrytëzuesve të NVMnëpërmjet vlerësimit se,në cilën shkallë NVM janë të vetëdijshëm që të qasen ndaj Fondit, dhe përgatitja e nismave për të adresuar faktorët të cilët përkufizojnë përdorimin e tij nga ana e NVM;
3. Përgatitja e fondeve investuese për mbështetje financiare të NVM studime për fondet ndërkombëtare sipërmarrëse dhe investuese;
4. Hulumtimi i mundësive për zgjerimin e rrjetit të engjëllit të biznesit;
5. Inkurajimi dhe lehtësimi i bashkëpunimit të përmirësuar ndërmjet komunitetit akademik dhe sektorit privat, duke përfshirë përdorimin e instrumenteve financiare, siç janë bonot e inovacionit dhe ofrimi i mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare për HZH dhe inovacion.

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë, **KПBPM** dhe **K3ПBPM**



*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

- Grupet e synuara:**
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
  - Fondi për inovacion dhe zhvillim teknologjik
  - Agjencia e zhvillimit të NVM (AMSRM etj.)
  - Organizata afariste dhe organizata të punëdhënësve

### Programi 3.3: Formimi i parqeve shkencore, teknologjike dhe inkubatorëve për inovacion

Qeveria do të shqyrtojë mundësitë e formimit e të paktën dy parqeve të teknologjisë të lidhura me universitetet dhe institucionet teknike, së bashku me të paktën pesë inkubatorë ose akseleratorëve për inovacion dhe qendrat start – up në nivel komunal apo rajonal. Në rastin e parë, Qeveria do të kryejë një studim fizibiliteti përformimin e parqeve shkencore - teknologjike. Për këtë qëllim do të qaset edhe ndaj përgatitjes të një strategjie për specializim të zgjuar me qëllim të identifikimit të sektorëve dhe industrivetë cilat kanë përparësi komparative dhe kapacitet përkatës për mëshitetjen e parkut shkencoro - teknologjik.

Nivelet e larta të inovacionit përmes NVM janë vendosur në objekte të specializuara.

**Rezultatet:** Arritje e niveleve më të lara përmes NVM të cilët janë të vendosur në kapacitete të specializuara.

- Aktivitetet kryesore:**
1. Përpunimi i një studimi fizibiliteti mbi shpenzimet dhe përfitimet që lidhen me hapjen e së paku dy parqeve teknologjike, të lidhura me universitetet dhe institucionet teknike si dhe identifikimin e mënyrave më të dëshirueshme të punës;
  2. Përpunimi i një studimifizibilitetimi shpenzimet dhe përfitimet që lidhen me hapjen e së paku pesë inkubatorëve apo akseleratorëve për inovacion dhe qendrat start – up në nivel komunal apo rajonal.

**Institucioni drejtues** Ministria e Ekonomisë, **KIPBPM** dhe **K3IPBPM**

- Grupet e synuara:**
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës
  - Ministria e vetëqeverisjes lokale

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

- Autoritetet rajonale dhe lokale
- Agjencia e zhvillimit të NVM (AMSRM etj.)
- Organizata afariste dhe organizata e punëdhënësve

7 Palët e përfshira kyçe dhe mekanizmat për zbatim

#### 7.1 Koordinim nga ana e Qeverisë

**Ministria e ekonomisë** ka përgjegjësi primare në zhvillimin e NVM.

#### 7.2 Përgjegjësitë për krijimin e politikave dhe mbikqyrjen

Ministria e Ekonomisë ka përgjegjësi primare për krijimin dhe mbikëqyrjen e politikave të NVM. Megjithatë, ka shumë ministri dhe organe tjera të cilat janë përfshirë në krijimin e politikave dhe përfaqësinë në kuadër të sektorit të NVM. Këtu përfshihen: **Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyra e Kryetarit të Qeverisë dhe Kabineti zëvendëskryetarit për çështje ekonomike.**

Përveç kësaj, **Këshilli Ekonomik dhe Social i Republikës së Maqedonisë**, i themeluar në vitin 1996, promovon dhe inkurajon dialogun social trepalësh në nivel kombëtar dhe lokal dhe punon në përmirësimin e dialogut social dypalësh në nivel të ndërmarrjeve dhe në përforcimin e kapaciteteve të Partnerëve social: nëpërmjet përfshirjes së tyre në të gjitha aktivitetet, gjë e cila paraqet një nga obligimet më të rëndësishme të ndërmarrja të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Këshilli ka rol këshillues dhe konsultativ në krijimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave ekonomike dhe sociale dhe në këtë mënyrë ndikon në arritjen e stabilitetit ekonomik dhe social në vend. ECC ka 12 anëtarë: katër anëtarë të Qeverisë, organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat.

#### 7.3 Zbatimi i programeve dhe shërbimeve për NVM

Infrastruktura aktuale e mbështetjes institucionale për NVM-të në Maqedoni u krijua dhe u forcua në dekadën e fundit. Kjo është shtytësi kryesor për zbatimin e masave individuale nga kjo Strategji për NVM-të dhe është lidhja më e rëndësishme e drejtpërdrejtë me sektorin e NVM-ve.

**Agjencia për mbështetjen e ndërmarrësisë (AMSRM)** është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për NVM-të. Misioni i AMSRM është promovimi i ndërmarrjeve dhe biznesvetë vogla duke zbatuar projekte prioritare që

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

pasqyrojnë fushat e ndërhyrjes në NVM-të të cilat udhëhiqen nga kërkesa dhe programet qeveritare për mbështetjen e ndërmarrjeve dhe rritjen e konkurrueshmërisë NVM. Përgjegjësitë kryesore të AMSRM janë:

- Krijimi dhe zhvillimi i infrastrukturës institucionale për mbështetjen dhe zhvillimin e sipërmarrësisë dhe konkurrueshmërisë në sektorin e NVM;
- Zbatimi dhe koordinimi i mbështetjes shtetërore dhe ndërkombëtare për NVM;
- Avancimi i ndërmarrësisë nëpërmjet llojeve financiare dhe jofinanciare të masave mbështetëse; dhe
- Zbatimi i programeve për masat dhe aktivitetet për mbështetjen e sipërmarrësisë dhe krijimin e konkurrueshmërisë në biznesin e vogël.

Organizatat tjera kyçe përfshijnë:

- Oda Ekonomike e Maqedonisë
- Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë
- Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore
- Organizatat e punëtorëve
- Konfederata e biznesit në Maqedoni
- Organizimi i punëdhënësve të Maqedonisë
- Oda e artizanatit
- Shoqata e grave të biznesit
- Shoqatat afariste: të paktën 20 shoqata vendore dhe bilaterale afariste që përfshijnë sektore të shumta të aktivitetit ekonomik, duke përfshirë katër me përfshirje kombëtare (Oda Ekonomike e Maqedonisë, Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë, Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri-Perëndimore, Oda e zejtarëve).
- Forumi i NVM.

**Komiteti kombëtar për inovacion dhe sipërmarrësi**, i themeluar në vitin 2011, i përbërë nga anëtarët e ministrive kryesore, komuniteti akademik dhe sektori i biznesit. Ky fokusohet në komercializimin e inovacioneve dhe në rritjen e nivelit të aktiviteteve inovative në komunitetin afarist dhe shoqërinë në tërësi. KKIS është përgjegjës për koordinimin e politikave qeveritare dhe masave për nxitjen e inovacionit dhe konkurrueshmërisë; koordinimin e shpërndarjes së mjeteve të buxhetit në mbështetje me prioritetet e Qeverisë, duke monitoruar punën e Fondit për inovacion dhe zhvillim teknologjik, duke shqyrtuar dhe miratuar programet për të mbështetur projektet dhe programet e zhvillimit të Fondit, para se, ata të hyjnë në procedurë para Qeverisë, rekomandimet e dhëna Qeverisë

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

në lidhje me programet dhe projektet e organizatave ndërkombëtare për mbështetjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të inovacionit, monitorimittë rregullt të politikave dhe masave të Bashkimit Evropian dhe vendeve me praktikat më të mira në fushën e inovacionit dhe vlerësimin e ndikimit të tyre, duke i'u dhënë rekomandime dhe sugjerime ministrive për aktivitetet e tyre në lidhje me risitë dhe dhënien e rekomandimeve dhe sugjerimeve Qeverisë në lidhje me mjedisin afarist, të drejtat e pronësisë intelektuale dhe mbështetjen për aktivitetet e inovacionit.

**Fondi për zhvillimin e inovacionit dhe teknologjisë**, ështëformuar për të inkurajuar dhe mbështetur aktivitetet inovative në NMVM për realizimin e zhvillimit të shpejtë teknologjik i bazuar në transferimin e njohurive, në hulumtimin e zhvillimit dhe të inovacionit që kontribuojnë në formimin e vendeve të punës për rritjen dhezhvillimin ekonomik, duke përmirësuar mjedisin e biznesit për zhvillimin e aftësive të konkurrueshmërisë së kompanive. Fushëveprimi i punës së Fondit bazohet në bashkë-financimin e NMVM-ve, me qëllim të nxitjes së aktiviteteve të inovacionit, implementimin e vendimeve dhe proceseve inovative, duke vendosurinovacione dhe transfere të teknologjivetek kompanitësi dhe mbështetje të kompanive të cilat kanë potencial të lartë të rritjes.Më tej, financimi i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të sapo formuara, fondacione dhe përsheptues, me qëllim të nxitjessë inovacionittek kompanitë dhe bartjen e rezultateve nga hulumtimet shkencore në aktivitete aplikimi apo komerciale, nëpërmjet "spin-of" kompanive, si dhe arritjen afatgjatëtkontributit pozitiv në zhvillimin e ekonomisë kombëtare, përmirësimin e konkurrueshmërisë nëpërmjet avancimeve teknologjike dhe operative, sigurimin e vendeve të reja të punës; mbështetjen e formimittë përsheptuesit teknologjik afarist, subjekte për dhënie të mbështetjes infrastrukurore të veprimtarisë inovative, me qëllim të përsheptimit të sipërmarrësisë duke mbështetur personat fizik të cilët dëshirojnë tëthemelojnë kompani, si dhe kompanitë e themeluara në fazën e tyre fillestare (të cilat ekzistojnë maksimum 6 vjet) duke siguruar ndihmë arsimore, logjistike dhe financiare.

**Rrjeti kombëtar i edukatorëve për ndërmarrësi**, e themeluar në vitin 2011 nga Qendra kombëtare për zhvillim tëinovacionit dhe mësim sipërmarrës, përfshin profesorë, asistentë nga universitetet dhe mësimdhënës të cilët ligjërojnë lëndën "Biznes dhe sipërmarrësi" dhe lëndë tjera ekonomike në shkollat e mesme në vend. Qëllimi kryesor i rrjetit është që të sigurojë mjete për krijimin e rrjeteve në mes të edukatorëve për ndarjen e praktikave më të mira në lidhje me arsimin

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*


e ndërmarrësisë, duke siguruar zhvillimin e mësimdhënësve dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit mësimor në të gjitha nivelet arsimore.

Në nivel lokal ekzistojnë më shumë aranzhime kryesore institucionale. Këto përfshijnë:

- Qendrat rajonale të biznesit: aktualisht funksionojnë dhjetë qendra rajonale, duke përfshirë pesë PECCtë vendosura në Shkup, Strumicë, Veles, Kumanovë, Manastir, tre APP në Ohër, Tetovë dhe Gostivar, Agjencia për zhvillim tëndërmarrjeve në rajonin e Prilepit dhe Qendrainformative afariste e romëve në Shkup.
- Aktualisht veprojnë tre inkubatorë afarist: Inkubatori SPARK në Manastir (i themeluar me përkrahje holandeze dhe në vitet e fundit i financuar nga USAID), inkubator i Shërbimit ndërmarrës të të rinjve në Shkup (financuar përmes ndihmës dypalëshe norvegjeze) dhe inkubatori i mbështetur nga Banka Botërore në Strumicë, përderisa dy start – up qendra plotësuese punojnë në Tetovë dhe Shkup, financuar nga SINTEF dhe Agjencia austriake për zhvillim, respektivisht.
- Rrjeti i ndërmarrjeve evropiane siguron mbështetje për të ndihmuar NVM të shfrytëzojnë më mirë mundësitë afariste në Bashkimin Evropian dhe të ofrojnë informacione dhe ndihmë për çështjet afariste lidhur me BE-në (p.sh. tregjet e BE-së, bashkëpunim afarist, kërkesa të partnerëve, financim dhe tenderë të BE-së, legjislacion të BE-së, standarde të BE-së, etj.).
- Janë vendosur tetë qendra të planifikimit në tetë rajone statistikore
- Biznis qendra start – up dhe Qendra kombëtare për zhvillim tëinovacioneve dhe mësimin sipërmarrës në kuadër të Fakultetit të Makinerisë në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi në Shkup.
- Konsulentë: këtu janë të përfshirë rreth 250 konsulentë "të pavarur" që do të ofrojnë shërbime konsulente afariste, si persona fizik apo juridik dhe disa konsulentë të caktuar ndërkombëtarë.

**Figura 1: Institucione për mbështetjen të NVM**

“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”



#### 7.4 Zbatimi dhe vlerësimi i strategjisë

Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për zbatimin e përgjithshëm të Strategjisë, në përputhje me planin e punës së bashkangjitur. Plani i punës i identifikon institucionet udhëheqëse, mbështetëse si dhe afatin kohor për të gjitha programet dhe aktivitetet. Ministria e Ekonomisë do të koordinojë këto institucione dhe do të monitorojë progresin e arritur. Do të zbatojë kornizën e monitorimit dhe vlerësimit që paraqitet në kapitullin tjetër. Ministria e Ekonomisë do të bëjë vlerësimin e Strategjisë në vitin 2020.

#### 7.5 Mekanizmat për koordinimin e donatorëve

Nuk ekziston mekanizëm formal për koordinimin e mbështetjes së donatorëve ndërkombëtarë dhe agjencive zhvillimore për zhvillimin e NVM në vend. Kjo Strategji për NVM mund të ofrojë një bazë për koordinimin e mbështetjes së donatorëve në fushën e zhvillimit të NVM. Brenda Shtyllës 1, Programi 1.1: Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit (Aktiviteti 1.1.5, shih planin e punës), Ministria e Ekonomisë do të formojë një organ koordinues për koordinimin e donatorëve për NVM për koordinimin dhe planifikimin e programeve të zhvillimit dhe proceseve për reformat e mjedisit afarist të cilët janë të mbështetur nga donatorët.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

## 8 Korniza për monitorim dhe vlerësim

### 8.1 Korniza për monitorim dhe vlerësim të nivelit të lartë

Zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë dhe monitorimi i realizimit të qëllimeve do të realizohet nga ana e institucioneve dhe organizatave të përfshira në Strategjinë (Ministria e Ekonomisë, **KIIBPM**, **3KIIBPM**, Ministria e Financave, Regjistri Qendror, Agjencia për ndërmarrësi etj)

Niveli	Rezultatet	Indikatorët
<b>Ndikimi (Vizioni)</b>	NVM e konkurrueshme maqedonase janë shtytës të rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe formimit të vendeve të punës produktive dhe të denja.	Kontributi i NVM drejt BPV-së Kontributi i NVM-ve ndaj punësimit Përdorimi i kontratave zyrtare të punësimit në NVM Numri i NVM-ve ku të gjithë punonjësit janë të regjistruar në mënyrë të rregullt Shkalla e përfaqësimit sindikal në gjithë fuqinë punëtore në NVM
<b>Rezultatet 1</b>	NVM në Maqedoni punojnë në një mjedis afarist të favorshëm që inkurajon sipërmarrësinë, investimet dhe produktivitetin, në përputhje me normat	Përmirësim i krijimit të politikave dhe koordinimit Zvogëlimi i kostove të pajtueshmërisë Dialog social i avancuar Monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	dhe standardet evropiane.	politikave, programeve dhe shërbimeve
<b>Rezultatet 2</b>	NVM-të në Maqedoni janë pjesëmarrës shumë produktivë dhe konkurrues në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.	Qasje më e mirë në shërbimet afariste dhe financiare Pjesëmarrje më e madhe në tregjet ndërkombëtare Rritjetë investimeve private në sektorët e rritjes strategjike.
<b>Rezultatet 3</b>	Konkurruenca ekonomike e Maqedonisë inkurajohet gjithnjë e më shumë nga sektori ndërmarrës dhe inovativ i NVM-ve.	Niveletë rritura të sipërmarrësisë Rritja e vlerës së shtuar në sektorin e NVM-ve Rritje e bashkëpunimit mes komunitetit afarist dhe akademik Infrastrukturë dhe kapacitet i përmirësuar për mbështetjen e inovacioneve dhe sipërmarrësisë

8.2 Korniza për monitorim dhe vlerësim të nivelit të programeve

8.2.1 Shtylla 1: Mjedis i favorshëm afarist

NVM-të në Maqedoni punojnë në një mjedis të favorshëm biznesi që inkurajon sipërmarrësinë, investimet dhe produktivitetin.

**Rezultatet** NVM në Maqedoni punojnë në mjedis të favorshëm afarist që i



*"Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse"*

1:	Inkurajon ndërmarrjet, investimet dhe produktivitetin.		
Nr.	Programi	Rezultatet	Indikatorët
1.1	Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit	Koordinimi i përmirësuar qeveritar dhe integrimi i politikave në kuadër të sektorit të NVM-ve dhe mekanizmi më i mirë për ofrimin e shërbimeve për zhvillimin e NVM.	Mekanizmat e krijuara për koordinimin e politikave Politikat integrohen në MSE të qeverisë Shërbimet e NVM dhe vendosja e grupeve të synuara Programet e mbështetjes së donatorëve janë në mbështetje me strategjinë
1.2	Thjeshtësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator	Kuadri ligjor dhe rregullator për NVM është "orientim afarist", me një numër të reduktuar të hapave dhe një kohë e duhur për të arritur pajtueshmërinë.	Janë zbatuar reforma të reja të mjedisit afarist Numër i zvogëluar i ndërmarrjeve joformale (gjegjësisht të paregjistruara) me Rritje përkatëse të numrit të shoqërive të regjistruara)
1.3	Fuqizimi dhe institucionalizimi i dialogut social	Është ngritur një mekanizëm për dialog të rregullt dhe të strukturuar social për të siguruar informacion mbi krijimin dhe reformimin e politikave, ligjeve dhe	Numri i organizatave afariste të përfshiera Numri i çlështjeve të cilët janë të kontraktuar bashkarisht me qeverinë dhe sektorin privat

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

1.4	Koordinimi i të dhënave për NVM në monitorim dhe vlerësim	<p>rregulloreve publike në sektorin e NVM.</p> <p>Të dhënat përkatëse sasiore dhe cilësore të ndara sipas gjinisë për sektorin e NVM-ve dhe trendet e tij janë përgatitur dhe bërë publike, së bashku me të dhënat nga monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i agjencive për mbështetjen e NVM.</p>	<p>Përmirësime në shumëllojshmërinë e të dhënave të mbledhura sasiore dhe cilësore</p> <p>Debatet publike në lidhje me të dhënat dhe konstatimet nga vlerësimi</p> <p>Ndryshime në krijimin e grupeve të synuara të programeve të zhvillimit të NVM</p> <p>Përmirësime në ndarjen e të dhënave sipas gjinisë, madhësisë, vendndodhjes etj.</p>
1.5	Shoqata kombëtare NVM	<p>Ndërmarrjet mikro dhe të vogla përfaqësohen në proceset e krijimit të politikave dhe shqyrtimin e programeve nëpërmjet anëtarësimit të tyre në Shoqatën kombëtare të NVM.</p>	<p>Pjesëmarrje e NVM në shoqatë</p>

8.2.2 Shtalla 2: Sektori produktiv dhe konkurrues i NVM

**Rezultate t 2:** NVM në Maqedoni janë pjesëmarrës të lartë produktiv dhe konkurrues në tregjet e tjera evropiane dhe ndërkombëtare.


*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Nr.	Programi	Rezultatet	Indikatorët
2.1	Përmirësimi i shërbimeve në zhvillimin afarist	VDPjanë më të rëndësishme në nevojat dhe aftësitë e zhvillimit të NVM dhe sigurohen në një mënyrë e cila është ekonomike, i koordinuar dhe i fokusuar në klient.	Informatat kthyes nga klientët Numri i NVM që kanë qasje në shërbimet mbështetëse (të ndara sipas gjinisë) Numri i ofruesve të VDPnga sektori privat Rritja e NVM-ve (punësim, qarkullim) të cilat mbështeten nga ofruesit e shërbimeve për NVM-të
2.2	Përmirësimi i qasjes në financa	NVM kanë qasje më të madhe në një vëllim më të gjerë të produkteve dhe shërbimeve financiare për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe rritjen e tyre.	Fushëveprimi i shërbimeve financiare të ofruara Numri i NVM-ve që kanë qasje në shërbimet e mbështetjes financiare (të ndara sipas gjinisë) Numri i mikro dhe ndërmarrjeve

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

			<p>të vogla që kanë qasje në financim nga bankat komerciale dhe format e tjera të financimit (të ndara sipas gjinisë)</p>
2.3	Lehtësimi i interkombëtarizimit	Pjesëmarrje e rritur e NVM në tregjet ndërkombëtare.	<p>Numri i NVM (të ndarë sipas gjinisë) që eksportojnë në tregjet ndërkombëtare</p> <p>Numri i NVM (të ndarë sipas gjinisë) të cilët kanë qasje në programet dhe shërbimet e qeverisë për mbështetjen e eksporteve</p> <p>Numri i grupimeve industriale të orientuara nga eksporti</p>
2.4	Mbështetje e zhvillimit të zinxhirit të vlerave	Rritja e pjesëmarrjes së NVM në sektorët strategjik industrial që janë	Numri i NVM (të ndarë sipas gjinisë) që punojnë në sektorët

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*



të orientuar drejt rritjes. strategjik industrial që janë të orientuar drejt rritjes. Numri i NVM-ve (të ndarë sipas gjinisë) të cilët kanë qasje në programe dhe shërbime qeveritare për të mbështetur industrinë strategjike

8.2.3 Shtylla 3: Ekosistem dinamik i ndërmarrjeve dhe inovacioneve

**Rezultatet 3:** Konkurrenca ekonomike e Maqedonisë inkurajohet gjithnjë e më shumë nga sektori ndërmarrës dhe inovativ i NVM.

Nr.	Programi	Rezultat	Indikatorët
3.1	Zgjerimi i ndërmarrjeve në arsim dhe trajnim	Aftësitë ndërmarrëse janë të integruar në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit.	Numri i studentëve meshkuj dhe femra që studiojnë aftësitë sipërmarrëse Numri i mësuesve dhe trajnerëve të cilët kanë mësuar aftësitë për mësime në trajnimin e ndërmarrësisë Numri i institucioneve të

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

3.2	Përmirësimi i shkencës, teknologjisë dhe inovacionit në zhvillimin e NVM-ve	Rritja e NVM-ve është nxitur nga rritja e transferimit të teknologjisë dhe inovacionit.	arsimit dhe trajnimit që ofrojnë trajnime për sipërmarrësinë  Numri i NVM-ve (të ndarë sipas gjinisë) të cilët kanë qasje në programe dhe shërbime qeveritare për mbështetje shkencore dhe teknologjike Shuma e mjeteve që NVM i investon në HZH Numri i produkteve dhe shërbimeve të reja të komercializuara
3.3	Formimi i parqeve shkencore dhe teknologjike dhe inkubatorëve për inovacion	Arritja e niveleve të larta të inovacionit përmes NVMtë cilët janë vendosur në objekte të specializuara.	Numri i NVM-ve (të ndarë sipas gjinisë) të cilët kanë qasje në programe dhe shërbime qeveritare për mbështetje shkencore dhe teknologjike Pjesëmarrja e NVM në kapacitetet e specializuara shkencore dhe inovative.

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

## PJESA 2: PLANI I VEPRIMIT (2017-2020)

### 1 Hyrje dhe pasqyrë e shkurtër e Strategjisë

Vizioni i strategjisë: **NVM (Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme) të Maqedonisë janë shtytës të rritjes ekonomike inkluzive dhe krijimit të vendeve të punës produktive dhe të denjë.**

**Objektivi i përgjithshëm i strategjisë:** Strategjia e NVM definon kornizë për bashkëpunim ndërmjet faktorëve nga sektori publik dhe privat dhe shoqërisë civile me qëllim që të mbështesë zhvillimin e NVM dhe inovacionit në drejtim të rritjes së konkurrueshmërisë së tyre.

Objektivi strategjik:

1. **Mjedisi i favorshëm afarist:** Të krijohet një mjedis i favorshëm afarist i cili do të inkurajon sipërmarrësinë dhe investimet.
2. **Spektori produktiv dhe konkurrues i NVM:** T'u ndihmohet NVM që të bëhen pjesëmarrës të lartë produktiv dhe konkurrues në tregjet evropiane dhe tregjet e tjera ndërkombëtare.
3. **Ekosistem dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacionet:** Të inkurajohet konkurrueshmëria ekonomike e Maqedonisë nëpërmjet rritjes së kapacitetit sipërmarrës dhe inovativ të NVM.

**NVM konkurruese maqedonase janë drejtues të rritjes ekonomike gjithëpërfshirëse dhe krijimit të vendeve të punës produktive dhe të denja**

NVM të Maqedonisë janë shtytës të rritjes ekonomike dhe inkluzive dhe krijimit të vendeve të punës produktive dhe të denjë		
SHTYLLA 1 Mjedisi i favorshëm afarist	SHTYLLA 2 Spektori produktiv dhe konkurrues i NVM	SHTYLLA 3 Ekosistem dinamik i sipërmarrësisë dhe inovacionet
PROGRAME	PROGRAME	PROGRAME
Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit	Përmirësimi i shërbimeve për zhvillim afarist	Zgjerimi i sipërmarrës isënë arsim dhe trajnim

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

Thjeshtësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator	Përmirësimi i qasjes ndaj financave	Përmirësimi i shkencës, teknologjisë dhe ino- vacionit në zhvillimin e NVM
Përforsimi dhe institucion analizimi i dialogut social	Lehtësimi i internaciona- lizimit	Formimi i parqeve shkencore dhe teknologjike dhe inkubatorëve për inovacion
Koordinimi i të dhënave për NVM dhe monitorimit dhe vlerësimit	Mbështetje në zhvillimin e zinxhirit të vlerës	
Asociacioni kombëtar i NVM		



“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”

## 2 Shtyllat dhe aktivitetet programore

Shtylla 1: Mjedisi i favorshëm afarist			
<b>Programi 1.1: Përmirësimi i krijimit të politikave dhe koordinimit</b>			
Përmirësimi i koordinimit dhe integritit të politikave që përfshijnë NVM, njëkohësisht duke përmirësuar mekanizmin për sigurimin e shërbimeve të zhvillimit të NVM.			
Rezultati: Koordinimi i përmirësuar qeveritar dhe integrimi i politikave në kuadër të sektorit të NVM dhe një mekanizëm më i mirë për ofrimin e shërbimeve të zhvillimit të NVM.			
1.1.1	Koordinimii politikave dhe programeve për mbështetjen e NVMnëpërmjet bashkëpunimit me të gjitha ministrinë, sektoret dhe agjencitë e qeverisë qendrores dhe me strukturat rajonale dhe lokale. Dy takime formale do të mbahen në nivel vjetor me të gjitha ministrinë, sektoret dhe agjencitë. Një takim formal me agjencitë rajonale dhe lokale do të mbahet për çdo vit.	Afati kohor:	Aktual
		Buxheti (EUR):	I rregullt
		Buxheti (MKD):	I rregullt
	<i>TREGUESI REZULTATEVE:</i>	Institucioni drejtues:	Ministria e Ekonomisë
	<i>Krijimi i një Trupi Koordinues Numri i takimeve të mbajtura koordinuese me ministrinë qeveritare, agjencitë për zhvillimin e NVM-ve dhe partnerët lokal</i>	Partnerët:	<b>KPIBPM</b> <b>K3PIBPM</b> Të gjitha ministrinë qeveritare, sektorët dhe agjencitë Autoritetet rajonale dhe lokale Agjencitë për Zhvillimin e NVM (AMSRM-së dhe të tjerë)
1.1.2	Vazhdimi i mbështetjes së AMSRM dhe institucioneve të tjera publike dhe organizatave të cilat mbështesin zhvillimin e NVM. Sigurimi i harmonizimit efektiv dhe	Afati kohor:	Aktual
		Buxheti (EUR):	I rregullt
		Buxheti (MKD):	I rregullt

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	<p>përkufizimi i qëllimeve të posaçme në raport të definicionit të vetëm për NVM.</p> <p>Buxhetet vjetore për mbështetjen e NVMnëpërmjet këtyre agjencive duhet të përcaktohen, përgatiten dhe dorëzohen në procesin e rregullt të buxhetit.</p>		
	<p><i>TREGUES I EZULTATEVE:</i></p> <p><i>Krijimi i një ligji të ri për NVM dhe harmonizimi i definicioneve të NVM në të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore relevante për NVM</i></p> <p><i>Niveli i mbështetjes financiare, teknike dhe organizative për agjencitë e zhvillimit të NVM</i></p>	<p><b>Institucioni drejtues::</b></p>	<p>Ministria Ekonomisë e</p>
		<p><b>Partnerët:</b></p>	<p><b>КПБPM</b> <b>КЗПБPM</b></p> <p>Agjencia për zhvillimin e NMV (AMSRM-së dhe të tjera</p>
1.1.3	<p>Zbatimii vlerësimit të agjencive për mbështetjen e NVM dhe shërbimeve të tyre. Aspektet kryesore që duhet të vlerësohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimi i agjencive për mbështetjen e NVMndaj sektorit të NVM;</li> <li>• Qëllimet e grupeve të përfshira të NVM;</li> <li>• Qëndrueshmëria e shërbimeve të ofruara financiare dhe <b>UDR</b>.</li> </ul>	<p><b>Afati kohor:</b></p>	<p>2018</p>
		<p><b>Buxheti (EUR):</b></p>	<p>25,000</p>
		<p><b>Buxheti (MKD):</b></p>	
	<p><i>TREGUES I REZULTATEVE:</i></p> <p><i>Raporti i vlerësimit</i></p>	<p><b>Institucioni drejtues:</b></p>	<p>Ministria Ekonomisë e</p>
		<p><b>Partnerët:</b></p>	<p>AMSRM-së, <b>ФИТР</b> dhe agjencitë tjera për zhvillimin e NMV</p>
1.1.4	<p>Rishqyrtimidhe zbatimi i një modeli për qëndrueshmërinë afatgjatë të</p>	<p><b>Afati kohor:</b></p>	<p>2019</p>
		<p><b>Buxheti</b></p>	<p>35,000</p>

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	shërbimeve mbështetëse për zhvillimin e NVM	(EUR):	
		Buxheti (MKD):	
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>  Dokument strategjik për shërbime të qëndrueshme dhe të orientuara drejt tregut për mbështetjen e NVM.	Institucioni drejtues:	Ministria e Ekonomisë
		Partnerët:	KПBPM, KЗПBPM, AMSRM-së, ФИТР dhe agjenci të tjera për zhvillimin e NVM-ve
1.1.5	Vendosja e një trupi koordinues të donatorëve për NVM mbi koordinimin dhe planifikimin e programeve dhe proceseve zhvillimore për reformat e mjedisit afarist të mbështetura nga donatorët.	Afati kohor:	Themeluar në vitin 2017
		Buxheti (EUR):	I rregullt
		Buxheti (MKD):	I rregullt
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>  Vendosja e një trupi koordinues të donatorëve Numri i takimeve të mbajtura të trupit koordinues për koordinimin e donatorëve të NVM-ve Raport vjetor për zhvillimin e NVM të mbështetura nga donatorët (në përputhje me strategjinë aktuale)	Institucioni drejtues:	Ministria e Ekonomisë
		Partnerët:	KПBPM, KЗПBPM, Të gjitha ministritë qeveritare, sektoret dhe agjencitë Agjencitë ndërkombëtare donatore dhe të zhvillimit që ofrojnë mbështetje për zhvillimin e NVM-AMS RM-së dhe agjencitë e tjera për zhvillimin e NVM
<b>Shtylla 1: Mjedisi i favorshëm afarist</b>			
<b>Programi 1.2: thjeshtësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator</b>			
Përpjekjet e vazhdueshme për përmirësimin e mjedisit afarist.			
Rezultati: Korniza juridike dhe rregullatore për NVM është „orientuar ndaj biznesit“, me numër të reduktuar të hapave dhe kohës së nevojshme për arritjen e pajtueshmërisë.			
1.2.1	Vazhdimi i reformave për	Afati kohor:	Aktual

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	<p>harmonizim më të lehtë dhe më të lirë:</p> <p>Programi vjetor për reformat e mjedisit afarist i përgatitur në konsultim me ministrinë, sektoret dhe agjencitë e tjera dhe me organizatat përfaqësuese afariste. Ky program do të plotësohet nga një raport vjetor mbi reformat e zbatuara në vitin paraprak.</p>	<p><b>Buxheti (EUR):</b></p>	100,000 në vit
		<p><b>Buxheti (MKD):</b></p>	
	<p><i>TREGUESIT E REZULTATEVE:</i></p> <p><i>Përgatitja e planit vjetor për reforma. Raporti vjetor mbi arritjet në reformën e mjedisit afarist.</i></p>	<p><b>Institucioni drejtues:</b></p>	Ministria e Ekonomisë
		<p><b>Partnerët:</b></p>	<p><b>KPIBPM, K3PIBPM,</b></p> <p>Të gjitha ministrinë qeveritare, sektoret dhe agjencitë duke përfshirë Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale</p> <p>Autoritetet rajonale dhe lokale</p> <p>Agjencitë për Zhvillimin e NVM (AMSRM-së dhe të tjera)</p>
1.2.2	<p>Rritja e përdorimit të <b>PVR</b> në ex-post vlerësimin: në mbështetje me obligimin për zbatimin eparimit „Mendosë pari për të voglat“ të ANV të KE-së, Qeveria do të implementojë "NVMtest" për ex ante analizë të efekteve të ndonjë propozimi legjislativ ndaj NVM. "NVM testi" përbëhet nga tre hapa kryesorë: (1) vlerësim preliminar të ndërmarrjeve që do të përfshihen, (2) matje e ndikimit ndaj NVM (gjegjesisht analize shpenzimeve dhe përfitimeve) dhe (3) përdorimi i</p>	<p><b>Afati kohor:</b></p>	2018
		<p><b>Buxheti (EUR):</b></p>	20,000
		<p><b>Buxheti (MKD):</b></p>	

*“Ndërrmarjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	masavetë lehtësimit, nëse kjo është edomosdoshme. Qeveria do të kryejë konsultime plotësuese me sektorin e NVM për këto procese dhe do të punojë me Ministrinë e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës për të përcaktuar obligime qeverisë në tërësi. Gjithashtu, do të kërkohet asistencë teknike nga KE-së.		
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>  <i>Vendosja e NVM testit</i> <i>Numri i procedurave të zbatuara nga NVM testi</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria Ekonomisë e
		<b>Partnerët:</b>	Ministria Shoqërisë Informatike dhe Administratës Organizatat përfaqësuese afariste e
1.2.3	Vazhdimi i reformave të procedurës së falimentimit duke përfshirë zvogëlimin e kohës së nevojshme për përfundimin e procedurës së falimentimit. Do të kërkohet asistencë teknike për rishqyrtimin e procedurës aktuale të falimentimit dhe për përgatitjen e kornizës ligjore dhe regulatorre të rishikuar.	<b>Afati kohor:</b>	2018
		<b>Buxheti (EUR):</b>	50,000
		<b>Buxheti (MKD):</b>	
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>  <i>Raporti i shqyrtimit</i> <i>Përgatitja e procedurave të reja</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria Ekonomisë e
		<b>Partnerët:</b>	Ministria Financave Organizatat përfaqësuese afariste e
1.2.4	Vendosja e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për identifikimin e shoqërive me vështirësi financiare me qëllim që të	<b>Afati kohor:</b>	2018: Rishikim 2019: përgatitja e programit për paralajmëruet të hershëm e

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	ndihmohet parandalimi i falimentimit: Do të kërkohet asistencë teknike për zbatimin e rishikimit të proceseve të raportimit financiar dhe zbulimit të të dhënave në kuadër të qeverisë dhe bankave komerciale. Do të zbatohet rishikimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm të KE-së. Do të përgatitet dhe zbatohet një program për paralajmërimin e hershëm .		2020: zbatimi i programit	i
		<b>Buxheti (EUR):</b>	2018: 50,000 2019: 25,000 2020: 20,000	
		<b>Buxheti (MKD):</b>		
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria Ekonomisë	e
	<i>Raporti i shqyrtimit Programi i përgatitur për sistemin mbi paralajmërimin e hershëm</i>	<b>Partnerët:</b>	Ministria Financave Organizatrat përfaqësuese afariste Bankat komerciale	e
1.2.5	Dizajnimi dhe zbatimi i fushatave informuese për promovimin e mundësisë së dytë të sipërmarrësve të cilët kanë dështuar më parë, por kanë fituar përvojë të vlefshme në raport të themelimit të një sipërmarrjeje;	<b>Afati kohor:</b>	2018: dizajnim 2019: zbatim 2020: zbatim	
		<b>Buxheti (EUR):</b>	2018: 25,000 2019: 35,000 2020: 20,000	
		<b>Buxheti (MKD):</b>		
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria Ekonomisë	e
	<i>Fushatë informative e zbatuar Anketimi i publikut</i>	<b>Partnerët:</b>	Ministria Financave Organizatrat përfaqësuese afariste Bankat komerciale	e
1.2.6	Dizajnimi dhe zbatimi i një fushate	<b>Afati kohor:</b>	2018: dizajnim 2019: zbatim	

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	për informim dhe ngitjen e vetëdijes për përfitimet e formalizimit (gjegjesisht inkurajimi i ndërmarrjeve për t’u regjistruar dhe sigurojnë të gjitha licencate nevojshme).		2020: zbatim
		<b>Buxheti (EUR):</b>	2018: 25,000 2019: 35,000 2020: 20,000
		<b>Buxheti (MKD):</b>	
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria Ekonomisë e
	<i>Fushatë informative e zbatuar</i> <i>Anketimi i publikut</i>	<b>Partnerët:</b>	Ministria Financave e Ministria e Punës dhe Politikës Sociale  Ministria e Vetëqeverisjes Lokale Autoritetet lokale Organizatrat përfaqësuese afariste
<b>1.2.7</b>	Rishqyrtimi i procesit të fshirjes së ndërmarrjeve nga regjistri:  Porosia, hulumtimi mbi numrin e ndërmarrjeve joaktive në evidencën e Regjistrit Qendror dhe inicimi i një reforme të procedurave për regjistrim që synojnë në fshirjen e ndërmarrjeve joaktive nga regjistri.	<b>Afati kohor:</b>	2018
		<b>Buxheti (EUR):</b>	25,000
		<b>Buxheti (MKD):</b>	
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Regjistri qendror
	<i>Është vendosur një proces i ri për</i>	<b>Partnerët:</b>	Ministria e

*“Ndërmarrjet e konkurrueshme të vogla dhe të mesme si shtytës të rritjes ekonomike përfshirëse”*

	<i>fshirjen e ndërmarrjeve joaktive nga regjistri.</i>		Ekonomisë Ministria e Financve
<b>1.2.8</b>	Reduktimi i shpenzimeve për start – ap ndërmarrjet nëpërmjet përpunimit të një analizenë të cilën do të definohen rekomandimet dhe masat konkrete.	<b>Afati kohor:</b>	2018
		<b>Buxheti (EUR):</b>	30,000
		<b>Buxheti (MKD):</b>	
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i> <i>Analizë e përpunuar</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Regjistri qendror
		<b>Partnerët:</b>	Ministria e Ekonomisë Ministria e Financve
<b>Shtylla 1: Mjedisi i favorshëm afarist</b>			
<b>Programi 1.3: Përforcimi dhe Institucionalizimi i dialogut social</b>			
Përforcimi i mekanizmave për konsultime dhe dialog me sektorin privat, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përfshirjes së grave afariste dhe sigurimit të përfaqësimit të mikro ndërmarrjeve.			
Rezultatet: Është krijuar një mekanizëm për dialog të rregullt dhe të strukturuar social për sigurimin e informacioneve mbi përgatitjen dhe reformimin e politikave publike, ligjeve dhe dispozitave në sektorin e NVM.			
<b>1.3.1</b>	Lidhshmëria me përfaqësuesite komunitetit të NVM për identifikimin e nevojave, interesave dhe potencialit për dialog të përmirësuar social.	<b>Afati kohor:</b>	2018
		<b>Buxheti (EUR):</b>	I rregullt
		<b>Buxheti (MKD):</b>	I rregullt
	<i>TREGUES I REZULTATEVE:</i>  <i>Numri i ndërmarrjeve të konsultuara</i>	<b>Institucioni drejtues:</b>	Ministria e Ekonomisë
		<b>Partnerët:</b>	<b>KIIBPM,</b> Organizatata përfaqësuese afariste
